

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

4994

Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 10/12.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 87

Datë: 05.12.2025 si dhe projekt-vendimin nr.02 Datë 26.11.2025.

“PËR MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE TË BASHKISË DIBËR PËR VITIN 2026”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ilir Elezi



Kapja
10.12.2025
[Signature]



4994/12/12/25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.1114/1 prot.

Peshkopi, më 11.12.2025

Lënda: Për vendimin nr.87, datë 05.12.2025 të Këshillit Bashkiak Dibër.

BASHKISË DIBËR
KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit Bashkiak Dibër nr.87, datë 05.12.2025 **“Për miratimin e Paketës Fiskale të Bashkisë Dibër për vitin 2026”**, vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

V E N D I M

Nr. 87 Datë 05 /12 /2025

**“PËR MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE TË BASHKISË DIBËR PËR VITIN
2026”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar,neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”,pika 1.1/b, si dhe neni 64 “Kompetencat dhe Detyrat e Kryetarit të Bashkisë”, ligji nr.44.2015 “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligji nr.687/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar,me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **05.12.2025**, me 19 vota pro, 2 kundër dhe 1 abstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2026 të Institucionit të Bashkisë Dibër.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore dhe të gjithë drejtoritë e tjera të Bashkisë Dibër.
3. Vendimi hyn në tërësi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall me datë **05.12.2025**.

Kryetari Këshillit Bashkiak

Sokol Sava



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

DREJTORIA TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

PROJEKT-VENDIM

Nr. 02 datë 26/11/2025

**“PËR MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE TË BASHKISË DIBËR PËR VITIN
2026**

Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e tij të datës ____/____/2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Dibër, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.1/b, si dhe neni 64 “Kompetencat dhe Detyrat e Kryetarit të Bashkisë” ligjit nr.44/2015 “Kodi i Proedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligji nr.687/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar:

Kërkojmë:

- I. Miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2026 të institucionit të Bashkisë Dibër.
- II. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore dhe të gjithë drejtoritë e tjera të Bashkisë Dibër.
- III. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR:

Përgjegjës Taksave dhe Tarifave Vendore


Bujar Manja

Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore

Fitim Raska

Drejtoria Juridik

Ismet Saraçi






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

PROJEKT PAKETA FISKALE VITI 2026



PROPOZIMI PËR PAKETËN FISKALE 2026

-Prezanton propozimet për sistemin e ri të taksave dhe tarifave që ne duam të zbatojmë për periudhën në vazhdim, duke qenë në linjë dhe në zbatim me prioritetet e strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Dibër dhe Planit të Zhvillimit të Territorit.

Propozimet konsistojnë në përmirësime teknike dhe proceduriale, për përgatitjen e një pakete fiskale të integruar, gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë.

Në mënyrë të përmbledhur kjo paketë fiskale synon:

a) Hartimin e një pakete të integruar.

b) Rishikimin e kornizës ligjore me qëllim përcaktimin e saktë të taksave, tarifave dhe çdo pagese tjetër që ndikon në buxhetet vendore dhe për të cilat njësia vendore duhet të arkëtojë të ardhura;

c) Saktësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësive për çdo taksë dhe tarifë, pjesë e kësaj pakete fiskale. Përcaktimi i saktë i të gjithë elementëve të lidhur me menaxhimin do të pasurojë akoma më tej dhe do të vendosë një bazë të fortë për ndërtimin e një sistemi fiskal eficient dhe transparent;

d) Përcaktimin e qartë dhe ndarjen në seksione të taksave nga tarifat. Çdo taksë dhe tarifë do të detajohet duke patur në konsideratë elementët:

✓ Taksim i drejtë;

✓ Tarifim mbështetur në kosto;

✓ Klasifikim i biznesit, qarkullim vjetor, lloji i aktivitetit;

✓ Qartësimi dhe përcaktimi i taksave apo tarifave që aplikohen për kategorinë e familjeve nisur nga lloji, vendndodhja etj;

Analiza e taksave që aplikohen për territorin që mbulon njësia (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha taksat, përcaktimi i bazës së taksueshme dhe aplikimi i kufijve që përcakton ligji.

e) Rikategorizimi dhe detajimi i taksave;

f) Analiza e tarifave që aplikohen për territorin që mbulon njësia (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha tarifat, përcaktimi i nivelit të tarifave mbështetur në koston e shërbimit për të cilin vendosen;

g) Aplikimi i iniciativave apo lehtësirave fiskale për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë, siç parashikon ligji.

Paketa Fiskale përmban:

	Nr/faqe
Përmbajtja administrative dhe metodologjia.....	2-3
1. Taksat	4-21
2. Tarifat.....	22-35
3. Të ardhurat jotatimore.....	36-51
4. Kundraajtjet.....	52-57
5. Baza ligjore.....	58-60

Përbërja administrative dhe metodologjia:

Dibra kufizohet në veri me Bashkinë e Kukësit, në veri-perëndim me bashkinë Mirditë, në perëndim me bashkinë Mat, në jug me bashkinë Bulqizë dhe në lindje me Republikën e Maqedonisë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Peshkopisë.

Bashkia Dibër përbëhet nga 15 Njësi Administrative, të cilat janë:

1 Peshkopi	9 Luzni
2 Selishtë	10 Tomin
3 Sllovë	11 Melan
4 Kala e Dodës	12 Kastriot
5 Zall-Dardhë	13 Lurë
6 Zall-Reç	14 Maqellarë
7 Fushë-Çidhën	15 Muhurr
8 Arras	

Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe **141 fshatra**.

Gjatë përgatitjes së paketës fiskale u konsideruan tre grupe administrative:

1. Grupi 1 – Njësia Administrative Peshkopi, Zona A
2. Grupi 2 – 4 Njësi Administrative (Maqellarë, Tomin, Melan, Kastriot), Zona B
3. Grupi 3-- 10 Njësi Administrative (Muhur, Luzni, Selishtë, Arras, Lurë, Zall Dardhë, Zall-Rec, Sllovë, Fushë-Cidhën, Kala e Dodës), Zona C

Kjo ndarje është bërë në bazë të situatës ekonomike të Njësive Administrative dhe shërbimeve të ofruara drejtpërsëdrejti nga pushteti lokal. Sipas ndarjes së grupeve të Njësive Administrative niveli i tarifimit për disa nga taksat dhe tarifatat vendore të tyre për biznesin e vogël do të aplikohet në nivele të ndryshme përkatësisht:

- Grupi 1 – Njësia Administrative Peshkopi Zona A (niveli 100 %)
- Grupi 2 – 4 Njësi Administrative (Maqellarë, Tomin, Melan, Kastriot) Zona B (niveli 70%).

- Grupi 3 - 10 Njësitë Administrative (Muhur, Luzni, Selishtë, Arras, Lurë, Zall-Dardhë, Zall-Reç, Sillovë, Fushë-Çidhën, Kala e Dodës) Zona C (niveli 50 %).

Në paketë janë përfshirë të gjithë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke përfaqësuar kështu 15 njësitë administrative në të njëjtën paketë.

Për hartimin e paketës fiskale për vitin 2026 janë angazhuar drejtuesit dhe specialistët në Bashkinë Dibër sipas taksave dhe tarifave që aplikojnë në departamentet përkatëse.

- Kabineti
- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore
- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
- Drejtoria Ekonomike
- Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Ujërave
- Drejtoria e Pyjeve
- Drejtoria e Shërbimeve Publike
- Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
- Drejtoria e Qendrës Balneare “Enver Shehu” Peshkopi (Llixhat)
- Drejtoria e Kopshteve dhe Cerdheve
- Drejtoria e MNZH-së
- Sektori i Higjienës, Shëndetësisë dhe Veterinarisë
- Sektori i Pyjeve dhe Kullotave
- Sektori i Administrimit të Ujërave
- Sektori i Mjedisit dhe Tokave
- Sektori i Konviktit
- Sektori i Prokurimeve
- Sektori i Shërbimit Social
- Sektori i Arsimit, Kulturës dhe Turizmit
- Sektori i Pronave
- Sektori i INUV
- Sektori i Gjendjes Civile
- Sektori i Policisë Bashkiake
- Qendra Kulturore Peshkopi
- Administratorët e Njësive Administrative

1: TAKSAT VENDORE

Ky seksion trajton taksat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:- Lloji, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

1.1 TATIM I THJESHTUAR MBI FITIMIN E BIZNESIT TË VOGËL

Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Neni 10,11

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 14,000,000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Baza e taksës/tatimi: Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 14 (katërmëdhjetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Mënyra e pagesës: Tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore ose në Postën Shqiptare, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës **20 prill**, për muajt: janar, shkurt e mars; brenda datës **20 korrik**, për muajt: prill, maj e qershor; brenda datës **20 tetor**, për muajt: korrik, gusht e shtator; dhe brenda datës **20 dhjetor**, për muajt: tetor, nëntor dhe dhjetor.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës/tatimit: Drejtoria Rajonale Tatimore, në rolin e agjentit tatimor, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Për këtë shërbim Drejtoria Rajonale e Tatimeve përfiton një komision prej 1 % të të ardhurave të mbledhura.

Niveli i tatimit: Nivelet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël paraqiten si mëposhtë:

Qarkullimi vjetor në vit	Shkalla tatimore në Bashkinë Dibër
0-14 milion	15 %
Mbi 14 milion	23% e fitimit

Bizneset e vogla që nisin aktivitet gjatë vitit 2026 në fushën e artizanatit dhe në fushën e grumbullimit dhe përpunimit të prodhimeve tekstile, bujqësore, blektorale, bimë medicinale do të përfitojnë reduktim të taksave në masën 30% për vitin 2026.

Për individët student të cilët janë diplomuar dy vitet e fundit, përkatësisht në vitin 2024 dhe 2025 dhe nisin aktivitetin si biznes i vogël për periudhën 01.01.2026-31.12.2026, për këtë periudhë (vitin 2026) gjatë të cilës do të ushtrojnë aktivitetin do të përfitojnë reduktim të detyrimeve vendore në masën 30% nqs aktiviteti i tyre do të jetë në fushën e artizanatit, përpunime të prodhimeve bujqësore e blektorale si dhe hapjen e sallave te internetit.

1.2 TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME

Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Neni 21 ANEKSI 1, Neni 23, ANEKSI 2

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive, përveç rasteve kur në ligj përcaktohen ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka sipas rastit pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- **Taksa mbi tokën bujqësore**
- **Taksa mbi ndërtesën**
- **Taksa mbi truallin**

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë (ndërtesë, tokë bujqësore, truall) përdoruesi i pasurisë bën një vetëdeklarim të sipërfaqes pranë bashkisë. Bashkia nëpërmjet komisionit të ngritur mund të vlerësojë sipërfaqen e taksueshme.

Përdorues quhet zotëruesi i pronës por që nuk ka dokumentacion ligjor që vërteton pronësinë e tij dhe jo personi që e shfrytëzon për biznes.

1.2.1 TAKSA MBI NDËRTESTAT

Vendimi nr.132 datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Burimet e mundshme të informacionit, për efekt të administrimit të taksës mbi ndërtesat, janë:

- Të dhënat e vetëdeklaruara nga taksapaguesi mbi ndërtesën/njësinë e ndërtesës në pronësi ose përdorim të tij;
- Të dhënat e disponuara nga ZVRPP-të lidhur me vlerësimin dhe rivlerësimin e ndërtesave, si dhe titujt e pasurisë mbi to;
- Të dhënat e urbanistikës për lejet e dhëna të ndërtimit;
- Të dhënat e Drejtoriave të noterisë për transaksionet e shitblerjeve të ndërtesave;
- Të dhënat e ASHK-së për ndërtesat në proces legalizimi;
- Të dhënat e siguruara nga verifikimi në terren nga vetë njësitë e vetëqeverisjes vendore;

- Të dhënat nga Regjistri qendror i gjendjes civile;
- Të dhënat nga subjekte ekonomike që kanë kontakte me konsumatorësi: Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Ndërmarrjet e ujesjelles-kanalizimeve apo dhe institucione të tjera të papërmendura më lart, të cilat disponojnë informacion mbi pasurinë ndërtesë/njësi ndërtese, tituj pronësie apo statusin juridik të marrëdhënies së taksapaguesit në marrëdhëniet e tij me pasurinë e paluajtshme, objekt taksimi, si dhe për vetë taksapaguesin;
- Të dhëna nga Agjensia e Trajtimit të Pronave për pasuri të trajtuara me vendime të KKKP-së.

Kategoritë dhe nënkategoritë, nivelet treguese të taksës mbi ndërtesën prezantohen si më poshtë vijon:

Njësitë Administrative përbërëse	Cmimi referues i miratuar	Shkalla e taksës e miratuar		Vlera për metër katror për banesat që përdoren/shfrytëzohen për banim		Vlera për metër katror për ndërtesat që përdoren/shfrytëzohen për zhvillim aktiviteti				
		Banim	Jo banim	Shtëpi/ Apartament (1)	Banese të privatizu ara në 1993, vetëm për shitjen e parë (0.7)	Njësi tregtimi dhe shërbimi (1.5)	Parkimi mbuluar ose bodrum (0.7)	Parkim I hapur (0.3)	Njësi industrial prodhimi magazi nimi (0.5)	Njësi që përdoren për bujqësi ose blegtori (0.3)
Peshkopi	49,000	0.05%	0.2%	24.50	17.15	147.00	68.60	29.40	49.00	29.40
Tomin	34,300	0.05%	0.2%	17.15	12.01	102.90	48.02	20.58	34.30	20.58
Melan	34,300	0.05%	0.2%	17.15	12.01	102.90	48.02	20.58	34.30	20.58
Kastriot	34,300	0.05%	0.2%	17.15	12.01	102.90	48.02	20.58	34.30	20.58
Maqellarë	34,300	0.05%	0.2%	17.15	12.01	102.90	48.02	20.58	34.30	20.58
Lurë	31,850	0.05%	0.2%	15.93	11.15	95.55	44.59	19.11	31.85	19.11
Muhurr	31,850	0.05%	0.2%	15.93	11.15	95.55	44.59	19.11	31.85	19.11
Luzni	31,850	0.05%	0.2%	15.93	11.15	95.55	44.59	19.11	31.85	19.11
Selishtë	31,850	0.05%	0.2%	15.93	11.15	95.55	44.59	19.11	31.85	19.11
Sllovë	31,850	0.05%	0.2%	15.93	11.15	95.55	44.59	19.11	31.85	19.11
Kala Dodës	31,850	0.05%	0.2%	15.93	11.15	95.55	44.59	19.11	31.85	19.11
Zall-Dardhë	31,850	0.05%	0.2%	15.93	11.15	95.55	44.59	19.11	31.85	19.11
Zall-Rec	31,850	0.05%	0.2%	15.93	11.15	95.55	44.59	19.11	31.85	19.11
Fushë- Cidhën	31,850	0.05%	0.2%	15.93	11.15	95.55	44.59	19.11	31.85	19.11
Arras	31,850	0.05%	0.2%	15.93	11.15	95.55	44.59	19.11	31.85	19.11

1.Sipërfaqja e prezumuar: Nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njesisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijojnë:

a) 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;
b) 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të ndryshuar.Për ndërtesat e tjera,të cilat nuk shërbejnë për qëllime banimi,njësitë e qeverisjes vendore bëjnë verifikimin në terren,për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës.Kur gjatë verifikimeve në terren konstatohen dëmtime të ndërtesave për shkaqe të fatkeqësive natyrore(tërmet/zjarr/përmbytje etj),të cilat ndryshojnë vlerën e kësaj pasurie,njësia e vetëqeverisjes vendore,sipas rastit që I paraqitet ngre një komision I cili vlerëson dhe korrekton vlerën e ndërtesës,Vlerësimi bëhet sipas gjendjes fizike në të cilën paraqitet ndërtesa e dëmtuar.

2.“Ndërtesë”, objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në ligj.

3.Bodrumet dhe nënçatitë e ndërtesave/ njësive pronësore, që, nga verifikimi në vend, rezultojnë se janë të destinuara apo shfrytëzohen për:

a) magazinim të sendeve familjare, pa pasur ndonjë qëllim fitimi, regjistrohen me komentin “bodrum/nënçati (sipas rastit) për mbajtjen e sendeve familjare”;

b) qëllime banimi, regjistrohen me komentin “për qëllim banimi”;

c) qëllime fitimprurëse, regjistrohen me komentin “për qëllime fitimprurëse”.

4.Në ndërtesat për veprimtari industriale përfshihen:ndërtesa prodhimi,përpunimi,magazinimi i mallrave industrial duke përfshirë fabrikat,depot,magazinat,e të tjera të ngjashme me to.

5. “Ndërtesë e papërfunduar”, 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por që nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Në nënkategorinë II “Ndërtesa” përfshihen:

a) Ndërtesa për tregti dhe shërbime:

Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat në pronësi të subjektit që e ka vënë në dispozicion për aktivitete si: hotele,motele,stabilimente turistike,shtëpi pritje turizëm familje,qendra biznesi,pika karburanti,magazinë,depo,bankat,zyrat,njësitë tregtare dhe ndërtesat për shërbime si:farmaci,klinika,spitale,maternitete,qendra shëndetësore të të gjitha specialiteteve dhe njësitë eshërbimit artizanal si:marangoz,këpucar,orëndreqës etj, të ngjashme me to.Shkollat,kopshtet,çerdhjet,qendrat kulturore,qendrat sociale,stadiumet,komplekse sportive si palestra,fitness,pishina të hapura e të mbyllura,ndërtesa shkencore si institute kërkimore,qendra kërkimore,internet,salla te koncerteve,videoteka etj,.

b) “Ndërtesa që përdoren për veprimtari prodhuese”

• Ndërtesa prodhimi.

Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat në të cilat ushtrohet aktivitet prodhues si: përpunim duralumini, metalesh,druri,tapicerie, letre kartoni, plasmasi, tulla, tjegulla, blloqe banimi,furra gëlqereje,prodhime ushqimore,prodhim konfeksionesh,prodhim dhe përpunim vajrash, nafte etj,

Shtypshkronja, prodhim dhe përpunim produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to.

Në rastet kur banesa (apo nje pjesë e saj) ndryshon destinacionin nga banim në veprimtari ekonomike (apo te tjera) detyrimi për sipërfaqen që ndryshon destinacionin paguhet jo me si ndërtesë banimi por sipas nënkategorisë: "Ndërtesë për tregti dhe shërbime".

- **Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në teritoret e miratuara si fshatra turistike.**

Në këtë nënkategori përfshihen ndërtesat e ndërtuara në zonat me përparësi turizmi të miratuara si të tillë.

Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje por që janë ende te pashitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të ambientit të ndërtesës.

Ambientet e regjistruara në Agjencinë Shtetërore Kadastrës si:

- Apartamentet e banimit do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë "Ndërtesa Banimi".

- Ndërtesat për biznes do ti nënshtrohen mbi ndërtesat në kategorinë "Ndërtesa të tjera për tregti dhe shërbime".

Për ato kategori ndërtesash banimi të cilat janë të regjistruara si seli të subjekteve tregtare, Taksa e Pasurisë përlllogaritet dhe paguhet si Kategoria II "Ndërtesa për ushtrim aktiviteti me qëllim përfitimi", për atë pjesë të sipërfaqes së ndërtesës në të cilën ushtrohet veprimtaria tregtare, duke u përjashtuar nga Kategoria I "Ndërtesa Banimi".

c) Ndërtesa të tjera

- Do të përfshihen pronat të cilat përdoren nga organizatat jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, zyrat e përfaqësimit të organizmave ndërkombëtare, ambasada të njohura ose të regjistruara si të tilla në gjykatë si dhe objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit kur janë objekte të ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-ndërmarrjeve shtetërore të privatizuara ku nuk zhvillohet aktivitet, pasuri (njësi shërbimi) që nuk shfrytëzohen.

Do të kuptojmë të gjithë objektet të cilat janë kapital i Ndërmarrjeve Shtetërore dhe kanë qënë kapital i ish-ndërmarrjeve shtetërore:

- Kur është objekt i ndërmarrjeve shtetërore ekzistuese të cilat janë tërësisht të amortizuara (vlera e amortizimit mbi 80 % e vlerës fillestare dhe ndryshimeve përkatëse sipas pasqyrave kontabël) ose kur objekti është i dëmtuar pavarësisht nga vlera e amortizimit. Për këto 2 lloje objektesh duhet të plotësohet kushti që ato janë jashtë funksionit dhe në to nuk ushtrohet asnjë veprimtari tjetër.

- **Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës:**

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor.

Për kategorinë I "Ndërtesa banimi" dhe kategoria III "Për pronësinë më shumë se një banesë", për kategorinë II "Ndërtesa të tjera" dhe kategorinë IV "Ndërtesa në pronësi apo përdorim në teritoret të miratuara si fshatra turistike.", detyrimi shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë ose pranë arkës së bashkisë brenda datës:

- Afati i pagesës është data 30 qershor e vitit fiskal.

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë brenda datës:

Afati i pagesës është data 30 qershor e vitit fiskal.

Afati i pagesës së taksës së pasurisë të bëhet me dy këste kur vlera është më e madhe se 300,000 lekë, kjo për ti dhënë mundësi bizneseve të bëjnë pagesat normalisht edhe për rastet kur kanë problem likuiditeti duke paguar këstin e parë deri me datë 20 prill të çdo viti dhe kësti i dytë të paguhet deri më 20 korrik të çdo viti.

Nëse subjekti taksapagues rregjistrohet rishtaz, pezullon veprimtarinë ose aplikon për çregjistrim pranë Q.K.B-së gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar nivelin e taksës për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë aplikimi për rregjistrim, pezullim ose çregjistrim) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

Tatimpaguesi i cili nuk arrin që brenda afatit të parashikuar të paguajë shumën e detyrimit tatimor, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0.06 përqind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. Përfshihen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

- Lehtësirat dhe përjashtimet

Përfshihen nga pagimi i taksës mbi ndërtesat:

- a) Pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore që përdoren për qëllime jofitimprurëse,
- b) Ndërtesat e banimit që shfrytëzohen nga qiramarrës me qira të paliberalizuara,
- c) Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare.
- d) Pasuritë në pronësi të shtetit të kaluara me VKM nën administrimin e shoqërive publike shtetërore.
- e) Taksapaguesi, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast lehtësimi ose përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga Këshilli Bashkiak në raport me dëmin e shkaktuar deri në vlerën 75%.
- f) Ndërtesat private në vend që zotërojnë statusin e monumentit të kulturës dhe janë në mbrojtje të përkohshme ose të përhershme.
- g) Subjektet hoteleri me 5 yje që kanë status special.
- h) Kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie ose pension social që janë me banim në fshat ose në qytet kur familja përbëhet vetëm nga pensionisti.
- i) Kryefamiljarët që trajtohen me ndihmë ekonomike.

1.2.2. TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006“Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 23, ANEKSI 2

ose në qytet kur familja përbëhet vetëm nga pensionisti.

i) Kryefamiljarët që trajtohen me ndihmë ekonomike.

1.2.2. TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006“Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 23, ANEKSI 2

Përkufizimi: “*Tokë bujqësore*” është toka e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurisë.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr.6, aktit të pronësisë, çertifikatës së regjistrimit të tokës.

Niveli i taksës mbi tokën bujqësore paraqitet si më poshtë:

Lekë/ha/vit

Kategoritë dhe nënkategoritë	Niveli i taksës dhe tarifës sipas ligjit	Niveli i taksës dhe tarifës në Njësine Administrative Peshkopi ZONA A	Niveli i taksës dhe tarifës në 4 njësitë administrative ZONA B	Niveli i taksës dhe tarifës në 10 njësitë administrative ZONA C
I	2,800	2,240	2,240	2,240
II	2,100	1,680	1,680	1,680
III	1,400	1,120	1,120	1,120
IV	1,350	1,080	1,080	1,080
V	1,250	1,000	1,000	1,000
VI	1,200	960	960	960
VII-X	1,100	880	880	880

Burimi: Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Në rast se një pronë shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose njësie administrative, pavarësisht nga vendbanimi i pronarit, secila njësi vendore e trajton pjesën e pronës, që ndodhet brenda territorit të vet, si pronë më vete dhe zbaton mbi të dispozitat e këtij ligji.

- Lehtësirat dhe përjashtimet

Përjashtohen nga taksa e tokës bujqësore vetëm për normën individuale të tokës, kryefamiljarët:

- Invalidët e punës e të luftës, veteranët;
- Të verbërit, individët me aftësi të kufizuara, paraplegjikë dhe tetraplegjikë;
- Pensionistët e vetëm;
- Tokat bujqësore që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Këto familje duhet të dorëzojnë në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë dokumentat e mëposhtëm:

- Librezën përkatëse.
- Vendimin e Këshillit të Bashkisë.

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Detyrimi llogaritet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe për familjarët pagesa bëhet nga qytetari pas dërgimit të faturës në çdo bankë të nivelit të dytë ose pranë arkës së bashkisë.

“Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës pranë Bashkisë ku ndodhet toka”.

- Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës

Ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë, për vlerësimin e kategorisë së tokës si dhe saktësimin dhe verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari, për çdo fermer/fermë. Ngarkohet sektori i Pronave në Bashki të saktësojë (AMTP) Aktin e marrjes së tokës në pronësi sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herëpashershme e ia përcjell këtë informacion Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore për llogaritjen e detyrimit.

Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e takses mbi token bujqësore për familjarët në njësinë administrative Peshkopi është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë bashkisë Dibër, kurse për njësitë e tjera administrative është njësia administrative.

1.2.3 TAKSA MBI TRUALLIN

Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 23/1

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.

Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme sipas tabelës së mëposhtme:

Lekë/m ² /vit					
Nr	Lloji	Vlera e taksës sipas Ligjit	Niveli i taksës në Njësinë Peshkopi ZONA A	Niveli i taksës në 4 njësitë administrative (Maqellarë, Melan, Tomin, Kastriot) ZONA B	Niveli i taksës në 10 njësitë administrative (Muhur, Luzni, Selishtë, Arras, Fushë-Cidhën, Lurë, Zall-Dardhë, Zall-Rec, Sllovë, Kala e Dodës) ZONA C
1	Taksë trualli (banimi)	0.28 lek/m ²	0.28 lek/m ²	0.28 lek/m ²	0.28 lek/m ²
2	Taksë trualli (Biznes)	15 lek/m ²	15 lek/m ²	15 lek/m ²	15 lek/m ²

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.

- Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës:

Deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë ose vetëdeklarimit të sipërfaqes së truallit, detyrimi vjetor referues i taksës së truallit për familjet llogaritet për një sipërfaqe prej 100 m².

Për biznesin detyrimi llogaritet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë brenda datës **30 qershor të vitit fiskal**. Për ata subjekte që nuk janë regjistruar pagesa e taksës së truallit bëhet në momentin e nxjerrjes së faturës së detyrimeve qëi takojnë biznesit.

Deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë ose vetëdeklarimit të sipërfaqes së truallit, detyrimi vjetor referues i sipërfaqes së truallit për bizneset llogaritet në bazë të sipërfaqes së ndërtesës së aktivitetit.

Tatimpaguesi i cili nuk arrin që brenda afatit të parashikuar të paguajë shumën e detyrimit tatimor, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0.06 përqind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Përjashtohen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e takses së truallit për familjarët në njësinë administrative Peshkopi është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë bashkisë Dibër, kurse për njësitë e tjera administrative është njësia administrative.

1.3 TAKSA E FJETJES NË HOTEL

Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Neni 26

Përkufizimi: Strukturat akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë: a) “Bujtinë”; b) “Fjetinë” (Hostel); c) “Kamping”; ç) “Hotel”; d) “Motel”; dh) “Resort”; e) “Qendër kurative”; ë) “Fjetje dhe mëngjes” (B&B).

Secila kategori e strukturave akomoduese klasifikohet me sistem të veçantë e shoqëruar me shenjat dalluese përkatëse sipas përcaktimit të mëposhtëm:

“Bujtinë” Standard, “Fjetinë” Standard, Komfort, “Kamping” Standard, “Hotel” me dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje;

“Motel” Standard, Komfort, Superior; “Resort” tre yje, katër yje, pesë yje; “Qendër kurative” dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; “Fjetje dhe mëngjes” (B&B) Standard, Komfort, Superior.

Baza e taksës: Është numri i netëve të qëndruara në hotel për person.

Niveli i taksës së fjetjes në hotel paraqitet si më poshtë:

Nr	Lloji	Niveli sipas Ligjit	Niveli i taksës në Njësinë Peshkopi ZONA A	Niveli i taksës në 4 njësitë administrative (Maqellarë, Melan, Tomin, Kastriot) ZONA B	Niveli i taksës në 10 njësitë administrative (Muhur, Luzni, Selishtë, Arras, Fushë Cidhën, Lurë, Zall-Dardhë, Zall-Rec, Sllovë, Kala e Dodës) ZONA C
1	Hotelet 4-5 yje	105 lekë/natë fjetje	74 lekë/natë fjetje	74 lekë/natë fjetje	74 lekë/natë fjetje
2	Bujtinë, llixha, fjetinë, balneare, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas	35 lekë/natë fjetje	35 lekë/natë fjetje	35 lekë/natë fjetje	35 lekë/natë fjetje

përcaktimeve të ligjit për turizmin				
-------------------------------------	--	--	--	--

Detyrimi dhe këstet e pagimit: Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia për netë qëndrimi me numrin e netëve të qëndrimit në hotel. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës. Detyrimi derdhet për bashkinë brenda datës 5 të muajit pasardhës nga subjekti përkatës.

Tatimpaguesi i cili nuk arrin që brenda afatit të parashikuar të paguajë shumën e detyrimit tatimor, detyrohet të paguajë një gjobë të barabartë me 0.06 përqind të shumës së detyrimit të papaguar për cdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast gjoha nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

1.4. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Neni 27

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

KATEGORITE DHE NENKATEGORITE	% sipas Ligjit	% në Njesine Administrativ e Peshkopi ZONA A	% ne 4 njësité administrative ZONA B	% ne 10 njësité administrative ZONA C
a.Ndërtime me funksion banimi dhe ambiente në funksion te tyre.	1%-3%	2 %	2 %	2 %
b.Ndërtime për shërbime dhe tregti	1%-3%	2.5 %	2.5 %	2.5%
c.Ndërtesa në proces legalizimi	0.5%	0.5 %	0.5%	0.5%
d. "Përgjashtimisht për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve,				

investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar."				
e.Ndertime per funksione banimi per shitje, pallate.	4%-8%	4.5 %	4.5%	4.5 %
f.Ndertime te vecanta	4%-8%	6 %	6 %	6 %

“Pagesa duhet të kryhet përpara tërheqjes së lejes përkatëse pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

-Ngarkohet për mbledhjen e kësaj takse Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”

Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa për çdo rast mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet për çdo rast për llogari të bashkisë që mbulon territorin ku do të bëhet investimi. Nëse objekti për të cilin do të bëhet investimi shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

Kushte lehtësuese: Në rast të zbatimit të një projekti të veçantë për efikasitetin e energjisë urbane(Sipas përcaktimeve në Ligjin Nr 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”) projekti verifikohet dhe nëse është zbatuar me përpikmëri atëherë subjektit i rimbursohet taksa e paguar mbi nivelin minimal të përcaktuar me ligj. Në rastet kur investitor është Bashkia, kjo taksë nuk aplikohet.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit e cila përcjell informacionin tek Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore. Të gjitha subjektet ndërtuese do të tërheqin lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Dibër vetëm pasi të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë.

TARIFAT E DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT	
Emertimi i tarifës	Niveli i taksës dhe tarifës
1. Shërbime gjatë marrjes së Lejes së Zhvillimit dhe Lejes së Ndërtimit	
a)Tarifë aplikimi për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për objekt banimi individuale nën 250m ²	5.600 lekë
b)Tarifë aplikimi për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për objekt banimi individuale mbi 250m ²	10.500 lekë
c) Tarifë aplikimi për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për objekte me qëllim biznesi apo institucion shtetëror	15.000 lekë
d) Tarifë aplikimi për Deklaratë Paraprake me funksion banimi	10.000 lekë

1. Shërbime gjatë marrjes së Lejes së Zhvillimit dhe Lejes së Ndërtimit	
a) Tarifë aplikimi për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për objekt banimi individuale nën 250m ²	8.000 lekë
b) Tarifë aplikimi për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për objekt banimi individuale mbi 250m ²	15.000 lekë
c) Tarifë aplikimi për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për objekte me qëllim biznesi apo institucion shtetëror	15.000 lekë
d) Tarifë aplikimi për Deklaratë Paraprake me funksion banimi	10.000 lekë
e) Tarifë aplikimi për Deklaratë Paraprake me funksion shërbimi	15.000 lekë
f) Tarifë aplikimi për leje zhvillimi dhe ndërtimi për banesa kolektive	50.000 lekë mbi 1000 m ² 30.000 lekë nën 1000 m ²
2. Shërbime gjatë ndërtimit të objektit	
	105 lekë/m ² të sipërfaqes totale të ndërtimit të objektit
a) Tarifat për ndryshim funksioni të objekteve	
b) Tarifa për ndryshim të subjektit zhvillues	10.000 lekë
3. Tarifa e marrjes së certifikatës së Lejes së Përdorimit të Objektit do të jetë sipas përshkrimit të mëposhtëm:	
a) Për objekt banimi individual nën 250m ²	105 lekë/m ² të sipërfaqes totale të objektit
b) Për objekt banimi individual mbi 250m ²	140 lekë/m ² të sipërfaqes totale të objektit
c) Për objekte komplekse banimi (apartamente në pallate për shitje)	175 lekë/m ² të sipërfaqes totale të objektit
d) Për objekte me qëllim biznesi, social kulturore dhe shëndetësore apo çdo lloj objekti tjetër	140 lekë/m ² të sipërfaqes totale të objektit
4. Tarifë aplikimi për objekte që nuk kërkojnë leje ndërtimi sipas nenit 6 VKM nr. 408 datë 13.05.2015	
	2.000 lekë

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e këtyre tarifave është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Dibër.

1.5. TAKSA MBI KALIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, Neni 9/5 dhe 28/2 Aneksi 3

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë etjetera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Niveli i taksës: Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Lekë/m²

Nr	Lloji	Niveli i taksës Sipas Ligjit	Niveli i taksës për Njësine Peshkopi ZONA A	Niveli i taksës për 4 njësitë administrative (Maqellarë, Melan, Tomin, Kastriot) ZONA B	Niveli i taksës për 10 njësitë administrative ZONA C
1	Ndërtesa banimi	100	100	100	100
2	Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	210	210	210	210
3	Ndërtesa të tjera	200	200	200	200

Detyrimi për pagesën: Taksa paguhet nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Mënyra e mbledhjes: Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), e cila në rolin e agentit të taksës përfiton 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdh për llogari të buxhetit përkatës të Bashkisë Dibër, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë të bëjë rakordimet dhe planifikimin e të ardhurave me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

- Përfashtimi nga taksa e kalimit të pasurisë.

Përfashtohen nga taksa për kalimin për pasuritë e paluajtshme:

- Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;
- Personat të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438 datë 28.12/1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar;
- Subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
- Institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
- Bashkësitë fetare dhe organizatat jofitimprurëse kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi pasi ka marrë vërtetimin nga Këshilli Bashkiak për

përfashtimin nga taksa bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

1.6 TAKSA VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA

Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Neni 30

Baza e taksës: është lloji i mjetit të transportit rrugor

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e mbledhjes së kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore, njëzet e pesëpërqind (25%) të të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Dibër.

1.7 TË ARDHURA PJESORE NGA TAKSA E RENTËS MINERARE

Baza e taksës: Janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e mbledhjes së kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, (5%) e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Dibër në llogarinë e degës së thesarit.

1.8. TAKSA E TABELËS

Ligji nr.9632 datë 30.10.2006“Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Neni 9 dhe 32/1 (ANEKSI 7)

Baza e taksës: Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjerapublike të lejuara ose private qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi.

Tabelë për qëllime identifikimi është tabela Brenda ose jashtë territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoret për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri ose lloji i aktivitetit të kompanisë ose jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikes për orientim. Taksa e tabelës paguhet për çdo njësi ku subjekti zhvillon aktivitetin nga muaji koherent që regjistrohet në QKB.

Në kategorinë e tabelës për qëllime reklamimi (të lëvizshme dhe të palëvizshme) kuptojmë të gjithë tabelat të vendosura në pamje joballore të vendosura në tarraca, llozhe, ballkone të vendosura në pjesë të rrugës, shtylla etj. që kanë përmbajtje reklamimi për vete ose të tretë.

Në kategorinë e tabelave në funksion apo ekspozime të ndryshme të hapura do të kuptojmë të gjitha ato tabela në funksion të panairove të ndryshme etj. që kanë për qëllim reklamimin për vete ose për të tretë.

Lekë/m ² /vit				
	Niveli i taksës sipas ligjit	Niveli i taksës në Njësinë Peshkopi	Niveli i taksës në 4 njësitë administrative	Niveli i taksës në 10 njësitë administrative
		ZONA A	ZONA B	ZONA C
Llojet e Tabelave				Niveli i taksës
I. Tabelë për qëllime identifikimi, të trupezuara ose jo brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtarinë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/aktiviteti i biznesit)				
a. Deri në 2m ²	0 lekë/vit	0 lekë/vit	0 lekë/vit	0 lekë/vit
b. Mbi 2m ² deri në 10 m ²				
- e thjeshtë (pa ndriçim)	7,000	7,000	7,000	7,000
- me ndriçim të thjeshtë	11,500	11,500	11,500	11,500
- elektronike	15,000	15,000	15,000	15,000
c. Mbi 10m ² deri në 20m ²				
- e thjeshtë (pa ndriçim)	5,950	5,950	5,950	5,950
- me ndriçim të thjeshtë	9,775	9,775	9,775	9,775
- elektronike	12,750	12,750	12,750	12,750
d. Mbi 20 m ² deri në 40 m ²				
- e thjeshtë (pa ndriçim)	3,850	3,850	3,850	3,850
- me ndriçim të thjeshtë	6,325	6,325	6,325	6,325
- elektronike	8,250	8,250	8,250	8,250
e. Mbi 40m ²				

- e thjeshtë (pa ndriçim)	2,800	2,800	2,800	2,800
- me ndriçim të thjeshtë	4,600	4,600	4,600	4,600
- elektronike	6,000	6,000	6,000	6,000
II. Tabela për qëllim identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat për orientim				
-tabela identifikuese	120	120	120	120
III. Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme dhe e palëvizshme.				
- e thjeshtë (me/pa ndriçim)	13,500	13,500	13,500	13,500
- elektronike	27,000	27,000	27,000	27,000
IV. Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj,	1,000 lekë/m ² /ditë	1,000 lekë/m ² /ditë	1,000 lekë/m ² /ditë	1,000 lekë/m ² /ditë

Në llogaritjen e taksës për tabelat më të mëdha se 10m², shumës së taksës së llogaritur për sipërfaqen deri 10m² do ti shtohet,shuma e taksës e llogaritur për diferencën e sipërfaqes së mbi 10 m² të shumëzuar me tarifën përkatëse të taksës.P.sh.,një tabelë të thjeshtë 15 m², shuma e taksës vetore do të llogaritet: (10m²*15000 lekë)+(5 m²*12 750 lekë)=150 000 +63 750=213 750 lekë në vit (ose 17 812 lekë/muaj). E njëjta llogjikë llogaritje do të jetë edhe për sipërfaqet e tabelave mbi 20m² dhe mbi 40 m².

Për subjektet taksapaguese që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese, vetëm njëra nga dy tabelat identifikuese do të konsiderohet e tillë, kurse tabela tjetër do të konsiderohet si reklamë. Cdo tabelë reklamimi që kalon sipërfaqen 35 m²,do të konsiderohet sikur është 35 m² dhe shuma e taksës llogaritet dhe paguhet vetëm për këtë sipërfaqe,pavarësisht madhësisë së saj në m².

Në kategorinë e reklamës kuptojmë cdo publicitet,formë promovimi që shërben për të njoftuar,tërhequr vëmendjen ose tërhequr blerësit,të vendosur në pamje jo ballore,në tarraca,lozhë,ballkone,në pjesë të rrugës,shtylla etj që kanë përmbajtje me qëllime reklamimi për vete ose të tretë.

Afatet e pagesës: Taksa e tabelës paguhet për cdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin, si dhe për cdo tabelë të vendosur.

Detyrimi për taksën e tabelës paguhet me një këst të vetëm, i cili paguhet brenda datës **30 qershor**. Për subjektet të cilat detyrimi i lind pas datës 1 qershor është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

Nëse subjekti taksapagues regjistrohet rishtazi, pezullon veprimtarinë ose aplikon për çregjistrim pranë Q.K.B-së gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar nivelin e taksës për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë aplikimi për rregjistrim, pezullim ose çregjistrim) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

Tatimpaguesi i cili nuk arrin që brenda afatit të parashikuar të paguajë shumën e detyrimit tatimor,detyrohet të paguajë një gjobëtë barabartë me 0.06 përqind të shumës së detyrimit të

papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Struktura e ngarkuar për miratim për të vendosur tabelë identifikuese/reklamuese është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Dibër bazuar kjo në kërkesën e vetë subjektit që do të vendosë tabelë identifikuese/reklamuese.

Struktura e ngarkuar për identifikimin, matjen dhe përlllogaritjen e kësaj takse është Drejtoria e Kontrollit të Territorit.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me “Njësinë Administrative”. Të ardhurat kalojnë 100% në Bashkinë Dibër.

2. TARIFAT VENDORE

Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Neni 35

Kjo pjesë trajton tarifat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

- Llojit të shërbimit, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agentët tatimorë.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës:

Detyrimi për familjarët shlyhet në bazë mujore si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë ose vetëm për taksat dhe tarifat vendore pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër SH.A bazuar mbi marrëveshjen e bashkëpunimit me Bashkinë Dibër me anë të “Marrëveshjes bashkëpunimit” nr.3773 datë 04.10.2023 e miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Dibër në cilësinë e agentit tatimor. Për shërbimin, agjenti përfiton përkatësisht 5% (pesë përqind) të shumës së arkëtuar. Familjarët të cilët nuk kanë kontratë me ujësjellësin faturohen nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për njësinë Peshkopi kurse për njësitë e tjera struktura e ngarkuar është njësi administrative në Bashkinë Dibër. Detyrimi për biznesin llogaritet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë, në sportelet e Posta Shqiptare sh.a Brenda datës 30 qershor të vitit fiskal.

2.1 TARIFA E PASTRIMIT DHE LARGIMIT TË MBETURINAVE

Vendim Nr.319 datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”

Përkufizimi: Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vëndas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Dibër dhe njësive të saj administrative.

Niveli i tarifës së pastrimit: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

Nr.	KATEGORITE	Peshkopi	Peshkopi	4 Njësité	4 Njësité	10 Njësité	10 Njësité	Të gjitha njësité
		BV	BM	BV	BM	BV	BM	BV me TVSH
I	Kategoria Familje	2,200		1,600		1,100		
II	Kategoria Biznes							
1	Shitje me pakicë/shumicë (TREGTI)							
	Fruta perime,ushqimore,mish,peshk	10,000	30,000	10,000	30,000	5,000	30,000	20,000
	Artikuj industriale(veshje,parfumeri,argjendari etj)	8,000	30,000	8,000	30,000	4,000	30,000	15,000
	Pub,diskoteka,lojëra fati	20,000	30,000	20,000	30,000	10,000	30,000	20,000
	Bar kafe,Fast food,kafe internet etj	8,000	30,000	8,000	30,000	4,000	30,000	15,000
	Bar restorant,hotel,motel,komplekse turistike	10,000	30,000	10,000	30,000	5,000	30,000	20,000
	Shitje produktesh farmaceutike,depo farmaceutike dhe të ngjashme me to	8,000	30,000	8,000	30,000	4,000	30,000	15,000
2	Njësi Prodhimi							
	Përpunimduralumini,Metalesh,druri,tapicerie,letrë,kartoni,plasma etj, Të ngjashme me to	15,000	30,000	15,000	30,000	7,500	30,000	20,000
	Impiante,territore për therjen e kafshëve etj, Të ngjashme me to	10,000	20,000	10,000	20,000	5,000	20,000	15,000
	Prodhime ushqimore,buke,ëmbëlsirash,mishi,peshku,bulmeti,pijesh etj, Të ngjashme me to	15,000	30,000	15,000	30,000	7,500	30,000	20,000
3	Subjekte Ndërtimi							
	Subjekte ndërtuese për selinë administrative	20,000	50,000	20,000	50,000	20,000	50,000	30,000
	Subjektet e ndërtimit sipas investimit deri në : a) 5,000 .000 lekë b)5,000 .000 - 25,000 .000 lekë c)25,000 .000-100.000.000 lekë d)mbi 100.000.000 lekë	a)20,000	b)30,000 c)40,000 d)100,000	a)20,000	b)30,000 c)40,000 d)100,000	a)20,000	b)30,000 c)40,000 d)100,000	

	Rikonstruksione të pjesshme	10,000	20,000	10,000	14,000	5,000	10,000	20,000
	Subjektet e ndërtimit për prodhim guri, inerte etj, Të ngjashme me to	20,000	50,000	20,000	50,000	20,000	50,000	30,000
4	Njësi shërbimi							
	Riparimi I artikujve elektro-shtëpiake radio, televizore. tj Shërbime fotokopjimi, sallon bukurie, auto servise, kurse për makina (autoshkolla), agjensi doganore, agjensi këmbimi valutë, agjensi turizmi, pastrim kimik, marangoz, rrobaqepës, etj, Të ngjashme me to.	5,000	15,000	5,000	15,000	5,000	15,000	10,000
	Kompleksesh sportive, palestra, fitness, pishina, qendra e institute kërkimore-shkencore, salla koncerte-mbledhje e videoteka, Lojera me kompjuter, Institucione jopublike të edukimit (shkollat, kopshte apo cerdhe), shërbimet në klinikat e specialiteteve të ndryshme mjekësore, shërbimet në laboratore diagnostifikimi	5,000	15,000	5,000	15,000	5,000	15,000	
5	Profesione të lira							
	Avokat, Noter, Mjek, Mjeku laborant, stomatologu, farmacisti, ekonomisti kontabël I miratuar, mësuesit, veterinerët, agronomët, botuesit, inxhinierët, arkitekti, profesione të lira të cilat ushtrohen në njësi fikse apo në ambiente të ndryshme etj, të ngjashëm me to	8,000	15,000	8,000	10,500	8,000	7,500	10,000
6	Ambulantë							
	Subjektet që nuk kanë një vendodhje fikse, taxi, tregtia ambulante në tregje publike dhe private							8,000
	Institucione shtetërore Buxhetore Shoqata, fondacione, ente të ndryshme shtetërore. Institucionet arsimore, kulturore, sportive private/shtetërore							300,000
	Bankat							100,000
7	Kompani Sigurimesh, Bastesh	15,000	30,000	15,000	30,000	15,000	30,000	20,000
	Kompani Telefonike Fondacionet Kredidhënëse, Arsimore etj,	15,000	50,000	15,000	50,000	15,000	50,000	20,000
	Ujësjiellësi							300,000
	OSHEE							300,000

8	<i>Spitali</i>	300,000						
	<i>Posta Shqiptare, ONE ALBANIA sh.a</i>	300,000						
	<i>Karburante, njësi tregtimi lëndësh djegëse, hidrokarbure etj, Të ngjashme me to</i>	15,000	30,000	15,000	30,000	15,000	30,000	15,000
	<i>Lavazhe</i>	15,000	30,000	15,000	30,000	15,000	30,000	20,000
	<i>Drejtoria Projektimi</i>	20,000	40,000	20,000	40,000	20,000	40,000	20,000
9	<i>Shoqëri transporti</i>							
	<i>a) brenda qarkut</i>	30,000	30,000	30,000	30,000	30,000	30,000	30,000
	<i>b) jashtë qarkut</i>	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000
	<i>Për çdo mjet transporti me Nipt Parësor apo sekondar sipas Q.K.B</i>							
	<i>a) Transport udhëtarësh deri në 8+1</i>	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000
	<i>b) Transport udhëtarësh mbi 8+1</i>	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000
	<i>c) Transport mallrash deri në 3.5 ton</i>	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000
	<i>d) Transport mallrash mbi 3.5 ton</i>	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000
9	<i>Miniera, ndërmarje vip etj, Sipas fuqisë prodhuese:</i>	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000
	<i>Hidrocentrale, hece etj, Sipas fuqisë prodhuese:</i>							
	<i>a) 0-2 mega</i>	130,000	130,000	130,000	130,000	130,000	130,000	130,000
	<i>b) mbi 2 mega</i>	260,000	260,000	260,000	260,000	260,000	260,000	260,000

Për shërbimin e depozitimit të mbetjeve në fushën e mbetjeve Peshkopi

-Bizneset të cilat do ti transportojnë me mjetet e tyre mbetjet që do të gjenerohen nga aktiviteti i tyre do të përjashtohen nga tarifa vjetore e pastrimit. Mbetjet do të depozitohen pasi të paguhet tarifa prej 250 lekë/ ton mbetje të ngurta urbane në zbatim të ligjit nr.10463“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” në bazë të fletëpeshores së sjellë nga biznesi së bashku me dokumentat shoqërues të llojit të mbetjeve. Nëse do të ketë dyshime Bashkisë Dibër i lind e drejta në çdo kohë të kontrollojë llojin dhe sasinë e mbetjeve. Nëse mbetjet do të jenë pa dokumentat e

fletëpeshores do të tarifohen me tarifën e vendosura për depozitimin e mbetjeve nga institucionet (me orë pune sipas manualit të çmimeve të ndërtimit).

-Për institucionet që kërkojnë shërbim të vecantë në venddepozitim (Agjensiadoganore Bllatë, AKU etj.) për shkak të natyrës specifike të punës së tyre në lidhje me asgjësimet shërbimi do të tarifohet duke marrë në konsideratë çmimet e manualit të ndërtimit të përcaktuar në VKM nr 629, datë 15.07.2015. Sipas rastit do të bëhet preventivi me orë punë për traktorin dhe fadromën që do të përdoret në venddepozitim.

Shënim: Tarifa e pastrimit për familjet në Grupin II dhe të III të ndarjes sipas njësive administrative do të aplikohet në njësinë administrative Maqellarë, Melan, Tomin, Kastriot, Muhurr, Fushë-Cidhën, Sllovë, Kala e Dodës pasi planifikohet të ofrohet ky shërbim nga Bashkia Dibër. Në rast se ky shërbim nuk do të ofrohet në fshatra të caktuara për arsye të ndryshme infrastrukturore nuk do të aplikohet tarifa e pastrimit.

Baza e tarifës: është vlera në lekë sipas kategorive e cila duhet të mbulojë koston e shërbimit.

Detyrimi për Tarifën e pastrimit është vjetor

Kategoria I: “Familjarët” Detyrimi llogaritet dhe paguhet për familje në çdo banke të nivelit të dytë ose pranë arkës së bashkisë. Për të llogaritur detyrimin për tarifën kjo kategori duhet të paraqesë pranë strukture së Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë çertifikatën e gjendjes familjare të lëshuar nga Drejtoria e Gjendjes Civile.

Kategoria II “Biznesi”: Detyrimi paguhet Brenda **datës 30 qershor**. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 qershor është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e regjistruara rishtaz detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKB-së.

Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar taksën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e përpjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

Për kategorinë **“Subjekte Ndërtimi”** nënkategorinë “Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, etj të ngjashëm me to “Rikonstruksione të pjesshme për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla kopshte, objekte banimi e tregtare, etj të ngjashëm me to”, llogaritja e taksës bëhet për periudhën nga momenti i ngritjes së kantierit të ndërtimit deri në momentin e dorëzimit nga subjekti pranë strukturave të Bashkisë Dibër të kërkesës për leje shfrytëzimi. Këtu përjashtohen kantieret e ndërtimit që përbëjnë vepra publike dhe financohen nga buxheti i Bashkisë apo buxheti i shtetit. Të ardhurat e krijuara nga tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është vendosur kjo tarifë.

Për të gjitha kategoritë: Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar taksën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

Lehtësirat dhe përjashtimet:

Përjashtime: Përjashtohen nga pagesa e tarifës së shërbimeve:

- Familjet që kanë k/familjarin invalidë të punës, invalidë të luftës;
- Familjet e veteranëve të luftës: familjet e dëshmorëve të Atdheut;
- Familjet që kanë në përbërjen e tyre të verbërit, individët me aftësi të kufizuar, paraplegjikë dhe tetraplegjikë që nuk kanë persona madhorë të aftë për punë.
- Pensionistët e vetëm.
- Bujtinat që do hapen gjatë vitit 2026 për vitin e parë ushtrimor.

Për të përfituar nga përjashtimi, këto familje duhet të dorëzojnë në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë dokumentat e mëposhtëm.

- Librezën përkatëse;
- Vërtetimin e papunësisë nga Drejtoria e punës.

Në kategorinë III “Biznesi”, fermerët që janë regjistruar me NIPT sipas vërtetimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore sipas udhëzimit Nr. 19, datë 3.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar” përjashtohen nga tarifa vendore për biznesin.

Përjashtohen nga tarifa vendore: Institucionet, subjektet dhe organizatat në pronësi të bashkisë; Institucionet dhe subjektet e varësisë së Bashkisë Dibër; Institucionet që shpenzimet operative ia mbulon vetë Bashkia Dibër; Komunitetet fetare të njohura me ligj.

Tatimpaguesi i cili nuk arrin që brenda afatit të parashikuar të paguajë shumën e detyrimit tatimor, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0.06 përqind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Përjashtohen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës:

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së pastrimit është Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër SH.A bazuar mbi marrëveshjen e bashkëpunimit nr.3773 datë 04.10.2023 me Bashkinë Dibër i caktuar si agjent tatimor, kurse familjarët të cilët nuk kanë kontratë me ujësjellësin faturohen nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për njësinë administrative Peshkopi kurse për njësitë e tjera struktura e ngarkuar është njësia administrative në Bashkinë Dibër.

2.2 TARIFA E NDRIÇIMIT PUBLIK

Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Neni 35

Përkufizimi: Tarifa e ndriçimit paguhet nga bizneset, vendasosetë huaj personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj që banojnë/janë rezidentë brenda territorit të Bashkisë Dibër.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të tarifës së ndriçimit janë të shprehura si më poshtë:

Kategorite	Njësia	Niveli i Taksës në Njësine Administrative Peshkopi ZONA A	Lekë/vit	
			Niveli i Taksës në 4 njësitë administrative ZONA B	Niveli i Taksës në 10 njësitë administrative ZONA C
1-FAMILJARE				
a) Familjet me të ardhura	Lekë/Vit	600	-	-
2-BIZNESI			-	
a) Biznesi i Vogël	Lekë/Vit	3,000	-	-
b) Biznesi i Madh	Lekë/Vit	5,000	-	-
3-Institucione ,	Lekë/Vit	5,000	-	-
Ambulantët	Lekë/Vit	1,000		

Detyrimi për taksën e ndriçimit është vjetor.

Kategoria I: “Familjarët” Detyrimi paguhet vjetor për çdo familje. Për çdo familje të re, afati i pagesës së tarifës së ndriçimit do të jetë 30 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjendjes Civile përkatëse dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj.

Kur detyrimi lind në 6-mujorin e dytë të vitit, subjektet paguajnë 50% të detyrimit. Të ardhurat e krijuara nga kjo tarifë, përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është vendosur kjo tarifë.

Tatimpaguesi i cili nuk arrin që brenda afatit të parashikuar të paguajë shumën e detyrimit tatimor, detyrohet të paguajë një gjobë të barabartë me 0.06 përqind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Afati i shlyerjes së detyrimit është data 30 qershor.

Përfshihen nga pagesa e gjobës për vonesë në pagesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës është Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër SH.A bazuar mbi marrëveshjen e bashkëpunimit nr.3773 datë 04.10.2023 me Bashkinë Dibër i caktuar si agjent tatimor kurse familjarët të cilët nuk kanë kontratë me ujësjellësin

faturohen nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për njësinë administrative Peshkopi kurse për njësitë e tjera struktura e ngarkuar është njësia administrative në Bashkinë Dibër.

Përfshirjet nga tarifa e ndricimit

- Personat të cilët kanë të ardhura nën minimumin jetik, sipas kriterëve të përcaktuara në nivel kombëtar (trajtohen me ndihmë ekonomike).
- Të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik. Me kushtin që këta të fundit të jenë kryefamiljarë dhe kur në gjendjen e tyre civile nuk kanë fëmijë në moshë apo persona të tjerë të aftë për punë.
- Kryefamiljarët gra me mbi dy fëmijë në ngarkim (nën 22 vjeç).
- Familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike.
- Kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes)
- Bujtinat që do hapen gjatë vitit 2026 për vitin e parë ushtrimor.

2.3 TARIFA E GJELBRIMIT PUBLIK

Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Neni 35

Përkufizimi: Tarifa e gjelbërimit paguhet nga bizneset vendas ose të huaj, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë brenda territorit të Bashkisë Dibër.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të tarifës së gjelbërimit janë të shprehura si më poshtë:

Kategoritë	Njësia	Niveli i Taksës në Njësine Administrative Peshkopi ZONA A	Lekë/vit	
			Niveli i Taksës në 4 njësitë Administrative ZONA B	Niveli i Taksës në 10 njësitë Administrative ZONA C
I) INSTITUCIONE	Lekë/Vit	3,000	2,100	1,500
II) AMBULANTET	Lekë/Vit	1,000	-	-
III) -BIZNESI				
a) Biznesi i Vogël	Lekë/Vit	1,400	980	700
b) Biznesi i Vogël me TVSH	Lekë/Vit	2,000	1,400	1,000
b) Biznesi i Madh	Lekë/Vit	3,000	2,100	1,500
c) Biznese Vip	Lekë/Vit	5,000	5,000	5,000

Tarifës së gjelbërimit i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Dibër. Kjo taksë paguhet për çdo njësi ku ushtron aktivitetin subjekti.

Detyrimi për Taksën e Gjelbërimit është vjetor. Për kategorinë II dhe III kur detyrimi lind 6/mujorin e dytë të vitit subjektet paguajnë 50 % të detyrimit.

Afati i shlyerjes së detyrimit është data 30 qershor. Për subjektet të cilave detyrimi i lind pas datës 1 qershor është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Të ardhurat e krijuara nga kjo tarifë, përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është vendosur kjo tarifë.

Tatimpaguesi i cili nuk arrin qëbrenda afatit të parashikuar të paguajë shumën e detyrimit tatimor, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0.06 përqind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

2.4 TARIFË E ZËNIES SË HAPËSIRAVE PUBLIKE

Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 35

Kjo taksë paguhet për zënien e hapësirave publike për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim mujor i tatimpaguesit. Taksa për zënien e hapësirës publike nuk zbatohet për hapësirat që nuk janë në pronësi dhe nën administrimin e pushtetit vendor.

Kategoritë dhe nënkategoritë për taksën e hapësirës publike, janë si vijon:

Lekë/m²/muaj

Lloji	Niveli i taksës sipas Ligjit	Niveli i taksës për Njësinë Peshkopi ZONA A	Niveli i taksës për 4 njësitë administrative ZONA B	Niveli i taksës për 10 njësitë administrative ZONA C
Zënie e hapësirës publike (përdorim trualli për tavolina)	60lekë/m ² /muaj	60lekë/m ² /muaj	60lekë/m ² /muaj	60lekë/m ² /muaj
Spektakle ose panairë të ndryshme	60lekë/m ² /muaj	30lekë/m ² /dite	30lekë/m ² /dite	30lekë/m ² /dite
Mallra jashtë vendit të tregtimit. Objekte të përkohshme me qëllim ushtrim aktiviteti tregtar, sipërfaqet të zëna me platforma ndërtimore, sipërfaqe të rrethuara me vazo, bimë dekorative, me	60lekë/m ² /muaj	60lekë/m ² /muaj	60lekë/m ² /muaj	60lekë/m ² /muaj

kangjella,drurë dekorativ,kufizime me plastmase dhe sende te tjera,etj të ngjashme me to.				
---	--	--	--	--

Detyrimi i taksës përlllogaritet si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivele tregues të saj.

Pagesa e taksës për zënie të hapësirës publike:

1. Për rastin e përdorimit të truallit me qëllim realizimin e spektakleve ose panairove të ndryshme, struktura e ngarkuar për mbledhjen e taksës është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pas marrjes së lejes për ushtrimin e aktivitetit.Kjo strukturë kryen dhe llogaritjen e detyrimeve për lejen përkatëse.
2. Për rastet e përdorimit të truallit për qëllim ushtrimi të aktivitetit tregtar si:vendosje mallrash jashtë vendit të tregtimit, sipërfaqet e zëna me platform,sipërfaqet e rrethuara me vazo me lule, bimë dekorative, me kangjella, dru dekorative, kufizime me plasmas dhe sende te tjera, etj të ngjashëm me to, detyrimi është mujor dhe pagesa do të bëhet brenda dates 30 të muajit përkatës.

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 33 “Taksat e përkohshme vendore” Këshilli Bashkiak vendosi që për çdo tavolinë të vendosur nga ana e subjekteve në hapësirë publike bazuar mbi një marrëveshje midis palëve të interesuara të vendosi tarifën 5,000 lekë në muaj për çdo tavolinë.

Struktura e ngarkuar për dhënie leje për zënie të hapësirave publike,matjen dhe përlllogaritjen e kësaj tarife është Drejtoria e Kontrollit të Territorit dhe për vjeljen e kësaj tarife është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Dibër.

Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos pajisje me leje për zënie hapësire publike është Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Kontrollit të Territorit.

2.5. TARIFA E SHËRBIMIT NË QENDRËN BALNEARE “ENVER SHEHU” (LLIXHAT) TË BASHKISË DIBËR.

Për çdo klient të shtruar në hotelin e saj dhe ato private do të paguajnë 250 lekë/ditë për klient të regjistruar, nga kjo 25 lekë i përket taksës së fjetjes në hotel, tarifë e bashkisë e cila i mbahet klientit për shërbimin (larjen) në Qendrën Balneare.

I. Tarifat e miratuar sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Dibër nr.33 datë 08.05.2024 “Për një ndryshim në Tarifat e Qendrës Balneare “Enver Shehu” Peshkopi, e konfirmuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër me nr. 422/1 prot. date 16.05.2024, si më poshtë:

- Tarifa për klientët që akomodohen në hotelin e Qendrës Balneare “Enver Shehu” Peshkopi (fjetjes në hotel, ushqimi me 3 vakte dhe 2 herë larje banje në ditë) të jetë në vlerën 2.000 lekë në ditë.
- Tarifa për hotelet me NIPT të jetë 250 lekë e ndarë kjo:
 - a- Tarifa për larje 225 lekë
 - b- Taksa e fjetjes ne hotel te jete 25 lekë
- Tarifa për klientët që marrin shërbimin e terapisë së baltës të jetë në vlerën 800 lekë për seancë.
- Tarifa për klientët që marrin shërbimin e fizioterapisë të jetë në vlerën 800 lekë për seancë.
- Tarifa për parkim Brenda ambjenteve të Qendrës Balneare “Enver Shehu” Peshkopi 100 lekë per dy ore parkim, 200 lekë mbi dy ore parkim.
- Tarifa për larjen në pishinë të jetë në vlerën 400 lekë për larje.
- Larja Ambulatore (vaskë) për qytetarët dibranë me biletë 150 lekë për larje.
- Kuota ushqimore për çdo klient që frekuenton hotelin e Qendrës Balneare “Enver Shehu” Peshkopi të jetë në vlerën 700 lekë në ditë.
 - Tarifa e larjes (vaskë) për çdo klient të shtruar në Hotel Privat do të jetë 250 lekë larje ku nga kjo tarifë 25 lekë i përket taksës së fjetjes në hotel, tarifë e bashkisë e cila do ti mbahet klientit për shërbimin.

2.6 DHËNIE LIÇENCA PËR TREGTIMIN E NAFTËS BRUTO DHE NËNPRODUKTEVE TË SAJ

Vendimi Nr.970 datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga Bashkia Dibër në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë do të ndërtohen në territor të saj.

Tarifë për dhënie licensa për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj

Njësia Tarifa

1. Dhënie dhe përsëritje e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet dhe vajrave lubrifikante për 5 vjet Lekë 1,000,000
--

2. Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë për 5 vjet Lekë 100,000
--

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

2.7 TARIFAT NË SEKTORIN E PYJEVE DHE KULLOTAVE

Vendimi Nr.391 datë 21.06.2006

2.7.1 TARIFË PËR SHITJEN E LËNDËS DRUSORE NË KËMBË

EMËRTIMI TARIFA		NJËSIA	
E hollë deri	E mesme dhe e trashë	22cm	mbi 22 cm
1.Lëndë punimi në këmbë			
A) Halore:			
Pishë e zezëm ³ 3,500		2,500	
• Bredh 3,800	m ³	2,700	
B)Fletore:			
• Ah 3,100	m ³	1,700	
• Dushk 4,000	m ³	2,300	
2.Dru zjarri			
A)Te forta			
• Dushk,ah,akacie,shkoze, mëllezë,bli,lajthi,thane	m ³	500	
B)Të buta			
• Halore,shelg,plep dhe verri	m ³	200	

2.7.2 TARIFE PER SHITJEN E LENDES DRUSORE NE KEMBE (për llojet industriale)

EMËRTIMI TARIFA	NJËSIA
--------------------	--------

Lëndë druri në këmbë

- Arrë, gështenjë, panjë, vidh m^3
6,700
- Carac, eukalipt, man, melleze, plep, rrap, shëlg, shkozë m^3
2,600
- Bli, frashër, gështenjë e egër, mështekën, verri m^3
5,000

Kur lënda e punimit dhe drutë e zjarrit janë nxjerrë nga sipërfaqe të djegura, por materiali drusor është i përdorshëm, tarifat për to do të jenë 40% më të ulëta se tarifat bazë.

2.7.3 TARIFAT DYSHEME PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME KONTRATË QERAJE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE

Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, mjedise sportive, çlodhëse etj.)

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lekë/ha/vit		
		1 vit	2 – 5 vjet	6 – 10 vjet
1	Pyll trungishte	180,000	120,750	100,000
2	Pyll cungishte	126,000	90,000	75,000
3	Pyll shkurre	126,000	90,000	75,000
4	Kullota	126,000	90,000	75,000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerrë	90,000	52,000	45,000
6	Inproduktive	90,000	52,000	45,000

Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lekë/ha/vit		
		1 vit	2-5 vjet	6-10 vjet
1	Inproduktive	540,000	495,000	440,000

Për vendosje antene të telefonisë fikse, të lëvizshme, televizive, radio-komunikimit

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lekë/ha/vit	
		1 – 5 vjet	6 – 10 vjet
1	Pyll trungishte	11,250,000	10,000,000
2	Pyll cungishte	8,500,000	8,000,000
3	Pyll shkurre	8,500,000	8,000,000

4	Kullota	8,500,000	8,000,000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerrë	6,500,000	5,500,000
6	Inproduktive	5,500,000	5,000,000

Për ndërtim objekte bare, restorante, karburante			
Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lekë/ha/vit	
		1 – 5 vjet	6 – 10 vjet
1	Pyll trungishte	7,500,000	7,125,000
2	Pyll cungishte	7,125,000	5,000,000
3	Pyll shkurre	7,125,000	5,000,000
4	Kullota	7 125,000	5,000,000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerrë	5,000,000	4,000,000
6	Inproduktive	5,000,000	4,000,000

Për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor ekzistues		
Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës për sipërfaqen e marrë në përdorim lekë/km/vit
1	Pyll trungishte	70,000
2	Pyll cungishte	50,000
3	Pyll shkurre	35,000
4	Kullota	35,000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	30,000
6	Inproduktive	25,000

Ndërtim linje të tensionit të lartë		
Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës km/vit
1	Pyll trungishte	60,000
2	Pyll cungishte	35,000
3	Pyll shkurre	25,000

2.7.4 TARIFAT PËR NGRITJEN E KAMPINGJEVE, QENDRAVE DHE OBJEKTEVE TË LËVIZSHME

Tarifat për ngritjen e kampingjeve, qendrave dhe objekteve të lëvizshme		
Nr.	Emërtimi	Tarifa (lekë/ditë/copë)
1	Çadra deri 4 vende	100
2	Çadra mbi 4 vende	200
3	Ruletë	500
4	Barakë portative	250

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e këtyre tarifave është Sektori i Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Dibër.

TARIFA TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË

2.8 TARIFA PËR SHËRBIME NGA INSTITUCIONET E VARËSISË NË BASHKINË DIBËR

Lloji i shërbimit	Niveli i taksës dhe tarifës
Tarife për leshim vertetim banimi dhe për cdo vertetim të leshuar nga Drejtoria t perkatese	200 lekë
TARIFA NË SEKTORIN E PYJEVE	
Tarifë për paisje me vërtetime transporti të lëndës drusore	200 lekë/vërtetimi
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË UJRAVE	
Sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak të vitit të mëparshëm (2021) dhe ligjit nr 24 datë 09.03.2017	
Tarifë për vaditjen e tokave bujqësore	100 lekë/30l/s (1,000 lekë/ha)
Tarifë e shërbimit	1,000 lekë/ha
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL	
- Vërtetim që trajtohet/nuk trajtohet me ndihmë ekonomike	200 lekë
- Vërtetim transfertë për ndihmë ekonomike	200 lekë

KLUBI SHUMËSPORTËSH “KORABI”	
Tarifa e dhënies në përdorim të palestrës jashtë ekipit shumësporteve	1,400 lekë për orë
QENDRA KULTURORE “HAKI STERMILLI”	
Tarifa e sallës së madhe me 450 vende	45,000
Tarifa e sallës për mbledhje mbi 2 orë	20,000
Tarifa e hollit deri në 4 orë/ditë	15,000
Regjistrimet në bibliotekë	
-për nxenesit e shkollave	100 lekë
-për të rriturit	200 lekë
DREJTORIA E GJENDJES CIVILE	
Për lëshimin e certifikatave për përdorim brenda vendit	50 lekë
Për lëshimin e dokumentit “Certifikatë për lidhje martese” në gjuhë të huaj	200 lekë
Për lëshimin e dokumentit “Certifikatë lindjeje” në gjuhë të huaj	200 lekë
Për lëshimin e dokumentit “Certifikatë martese” në gjuhë të huaj	200 lekë
Për regjistrimin e shtetasve të huaj, pas dhënies së shtetësisë shqiptar	2,000 lekë
Për mbajtjen e akteve të lidhjes së martesës	1,000 lekë
Për procedurën për veçim/bashkim familjesh të shtetasve	1,000 lekë

2.9 TARIFA PËR QENDRËN EKONOMIKE TË ARSIMIT

Për fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet paguhet tarifa:

Emërtimi tarifës	Kopshte	Çerdhe
Tarifë për ushqimin	170 lekë/ditë/fëmijë	140 lekë/ditë/fëmijë
Tarifë e regjistrimit (garanci)	2,200 lekë	2,200 lekë

--	--	--

Tarifa për ushqimin për fëmijët në kopshte të bëhet 170 lekë/ditë/fëmijë dhe do të paguhet nga ana e fëmijëve vetëm tarifa 140 lekë dhe diferencën prej 30 lekësh do të subvencionohet nga ana e bashkisë si rezultat i rritjes së çmimeve të mallrave ushimorë në përcaktimin e kuotës ditore të ushqimit. Ndërsa tarifa për ushqimin për fëmijët në çerdhe të bëhet 140 lekë/ditë/fëmijë dhe do të paguhet nga ana e fëmijëve vetëm tarifa 110 lekë dhe diferencën prej 30 lekësh do të subvencionohet nga ana e bashkisë. Tarifa e regjistrimit (Garancia) kthehet në fund të vitit kalendarik 2026.

Detyrimi mujor përbëhet nga Tarifa për Ushqimin 170 lekë/ditë/fëmijë, ku kjo e fundit përllogaritet me nivelin ditor të tarifës dhe ditët e frekuentimit të fëmijës në çerdhe/kopshte gjatë 1 muaji. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Qendra Ekonomike e Arsimit Dibër, Bashkia Dibër.

Për nxënësit e shkollave të Mesme që akomodohen në konviktin e Shkollës Profesionale “Nazmi Rushiti” (për nxënësit me pagesë).

Emërtimi itarifës	Konvikte
Tarifë për ushqimin	206 lekë/ditë/nxënës
Tarifë e regjistrimit (Garanci)	3,000 lekë/vit/nxënës

Emërtimi i tarifës	Konvikte
Tarifë e Shërbimit në Konvikte për nxënësit që ndjekin gjimnazin “Seit Najdeni”	10,000 vit/nxënës

Ndërsa për nxënësit e shkollës së Mesme Profesionale përjashtohen nga kjo tarifë sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak **Nr.96 datë 27.09.2017**

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

2.10 TARIFE PER LINJAT AJRORE DHE NENTOKESORE *(Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)*

	Njësi	Vlerë
1. Për linjat ajrore	lekë/km/vit	3.000
2. Për linja nëntokësore	lekë/km/vit	2.000

Tarifë për dhënie në përdorim të tubacioneve nëntokësore për shtrirjen e linjave nëntokësore (telefoni, energji, tv kabllor, internet)

Baza e tarifës për dhënie në përdorim të tubacioneve nëntokësore për shtrirjen e linjave nëntokësore (telefoni, energji, tv kabllor, internet) është gjatësia lineare për kilometër e linjave nëntokësore e cila vihet në përdorim për shfrytëzim nga subjekte për qëllime biznesi. Tarifa llogaritet si detyrim vjetor i subjektit duke shumëzuar bazën e taksës (gjatësinë lineare për kilometër) me nivelin tregues të saj.

Struktura e ngarkuar për identifikimin dhe matjen është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Struktura e ngarkuar për lidhjen e kontratave për dhënie në përdorim të tubacioneve nëntokësore, për shtrirjen e linjave nëntokësore (telefoni, energji, tv kabllor, internet) është Drejtoria Juridike.

Struktura e ngarkuar për përlllogaritjen e tarifës për dhënie në përdorim të tubacioneve nëntokësore, për shtrirjen e linjave nëntokësore dhe për vjeljen e saj është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Dibër.

2.11 TARIFA E SHËRBIMEVE QË KRYEN POLICIA E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT NDAJ SHTETASVE DHE PERSONAVE, JURIDIK E FIZIK, VENDAS E TË HUAJ.

Në zbatim të Vendimit nr.607 datë 29.07.2020 “Për tarifën për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

1. Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri për objekte të destinuara për banim

- 1.1 Për objekte me lartësi deri në 12 metër, tarifa është 5,000 (pesë mijë) lekë.
 1.2 Për objekte me lartësi nga 12 deri në 24 metër, tarifa është 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë
 1.3 Për objekte me lartësi nga 24 deri në 32 metër, tarifa është 20,000 (njëzet mijë) lekë.
 1.4 Për objekte me lartësi nga 32 deri në 54 metër, tarifa është 30,000 (tridhjetë mijë) lekë.

2. Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik (sektori i bujqësisë, sektori i industrisë, sektori i transportit, sektori i tregtisë, sektori i turizmit, sektori i shërbimeve, etj.)

- 2.1 Për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi deri në 500 m², tarifa është 5,000 (pesë mijë) lekë.
 2.2 Për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi deri në 1 000 m², tarifa është 10,000 (dhjetë mijë) lekë.
 2.3 Për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi deri në 2000 m², tarifa është 20,000 (njëzet mijë) lekë.
 2.4 Për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi deri në 3,000 m², tarifa është 30,000 (tridhjetë mijë) lekë.
 2.5 Për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi mbi 3,000 m², tarifa është 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

3. Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, përveç objekteve të përcaktuara në pikën 2, të kësaj shtojce, për objektet/ aktivitetet me rrezikshmëri të lartë zjarri

- 3.1 Për stabilimente për përpunimin e drurit me materiale në përpunim dhe/ose në ruajtje, tarifa është 10,000 (dhjetë mijë) lekë.
 3.2 Për fabrika dhe impiante ku prodhohen, përpunohen dhe/ose mbahen produktet e tekstilit, natyrore /artificiale, produktet e linoleum-it dhe produkte të tjera të ngjashme, tarifa është 10,000 (dhjetëmijë) lekë.
 3.3 Për stabilimentet dhe impiantet për prodhimin, përpunimin dhe rigjenerimin e laboratorëve të gomës, depozitat e gomës, pneumatikëve dhe produkteve të ngjashme, tarifa është 10,000 (dhjetë mijë) lekë.
 3.4 Për depot ku prodhohen, përpunohen dhe/ose mbajnë plastikë, tarifa është 10,000 (dhjetë mijë) lekë.
 3.5 Për stabilimentet dhe impiantet për prodhimin, letër dhe karton, dhe përgatitja e produkteve të letrës në përgjithësi, tarifa është 10,000 (dhjetë mijë) lekë.

4. Shërbimi për vlerësimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për objektet/aktivitetet ku janë të instaluar pajisje nën presion

Për rezervuarë gazi të lëngshëm, në sasi totale masive më të mëdha se ose të barabartë me 75 kg deri në 300 kg, tarifa është 10,000 (dhjetë mijë) lekë.

4.2 Për rezervuarë gazi të lëngshëm, në sasi totale masive më të mëdha se ose të barabartë me 300 kg deri në 1000 kg, tarifa është 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

4.3 Për rezervuarë gazi të lëngshëm në sasi totale masive më të mëdha se ose të barabartë me 1000 kg, tarifa është 20,000 (njëzet mijë) lekë.

4.4 Për stabilimente/impliante ku lëngjet e ndezshme dhe/ose të djegshme me pikë ndezjeje prodhohen dhe/ose përdoren deri në 125°C, me sasi totale në cikël dhe/ose në ruajtje, më e madhe se 1 m³, tarifa është 10,000 (dhjetë mijë) lekë.

4.5 Për stabilimente/impliantet për përgatitjen e vajrave vajosëse, vajrave diatermike dhe të ngjashme, me pikë flakërimi më të lartë se 125°C, me sasi më të larta të përgjithshme në cikël dhe/ose në ruajtje deri në 5 m³, tarifa është 10,000 (dhjetë mijë) lekë.

4.6 Për stabilimente/impliante për përgatitjen e vajrave vajosëse, vajrave diatermike dhe të ngjashme, me pikë flakërimi më të lartë se 125°C, me sasi më të larta të përgjithshme në cikël dhe/ose në ruajtje deri 100 m³, tarifa është 20,000 (njëzet mijë) lekë.

4.7 Për stabilimente/impliante për përgatitjen e vajrave vajosëse, vajra diatermike dhe të ngjashme, me pikeflakërimi më të lartë se 125°C, me sasi më të larta të përgjithshme në cikël dhe/ose në ruajtje mbi 100 m³, tarifa është 20,000 (njëzet mijë) lekë.

4.8 Për sisteme të shpërndarjes së karburantit të lëngshëm, kontejnerët e palëvizshëm të karburanteve të lëngshëm deri në 9 m³, me pikë të ndezjes mbi 65°C, tarifa është 10,000 (dhjetë mijë) lekë.

4.9 Për sisteme fikse për shpërndarjen e karburanteve të gaztë dhe tipit të përzier (të lëngshëm dhe të gaztë), tarifa është 20,000 (njëzet mijë) lekë.

4.10 Për sisteme të shpërndarjes së gazit të karburantit për automjete motorike dhe sisteme të shpërndarjes së palëvizshme për benzinë, naftë dhe miks automobilistik, për përdorim publik dhe privat, tarifa është 20,000 (njëzet mijë) lekë.

5. Shërbimi për vlerësimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për objektet/aktivitetet e mëposhtme:

5.1 Për hidrocentrale, HEC (primar, sekondar) etj, implianteve të prodhimit të energjisë elektrike, të rinovueshme, diellore, ere, etj, tarifa është 20,000 (njëzet mijë) lekë.

5.2 Për vend depozitime të mbetjeve të ngurta, tarifa është 10,000 (dhjetë mijë) lekë.

5.3 Për rrugë, hekurudha, ura, tunele, tarifa është 20,000 (njëzet mijë) lekë.

6. Për vlerësimin dhe miratimin e ndryshimeve të projektit të MZSH-së, të miratuar më parë nga struktura e MZSH-së, për shkak të instalimit të sistemeve të reja, zgjerimit apo ristrukturimit të aktiviteteve ekzistuese, tarifa është 5,000 (pesë mijë) lekë.

7. Për dhënien e çertifikatës së sigurisë nga zjarri, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objektet që ushtrojnë aktivitete, sipas klasifikimit të rrezikshmërisë nga zjarri, tarifa është 5,000 (pesë mijë) lekë.

8. Për ripërtëritjen periodike të çertifikatës së sigurisë nga zjarri, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, tarifa është 2,000 (dy mijë) lekë.

9. Për lëshimin e vërtetimit të zjarrit (shoqëruar nga raporti i ndërhyrjes), nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, tarifa është 1,000 (një mijë) lekë.

10. Për lëshimin e vërtetimit (shoqëruar nga akti i kontrollit i kryer nga inspektori i shërbimit të MZSH-së), për depozitat e gazeve të ndezshme, të ngurta, apo plazma në automjete të lëvizshme rrugore, nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, tarifa është 1,000 (një mijë) lekë
11. Për inspektimin e objekteve për masat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, kur inspektimi nuk është i autorizuar nga shërbimi i MZSH-së, por kërkohet nga vetë subjektet fizikë dhe juridikë, tarifa është 5,000 (pesë mijë) lekë për një orë.
12. Për vënien në dispozicion të personelit dhe të një automjeti në zhvillimin e aktiviteteve sportive, kulturore, si panaire, ekspozita, koncerte, shfaqje, festivale të ndryshme, në mjedise të hapura dhe të mbyllura publike, si dhe gjatë zhvillimit të aktiviteteve sportive kombëtare apo ndërkombëtare, tarifa është 10,000 (dhjetë mijë) lekë për një orë.
13. Për ofrimin e shërbimeve subjekteve private me automjete zjarrfikëse, me pajisje zjarrfikëse, apo me auto shkallë, tarifa është 10,000 (dhjetë mijë) lekë për një orë.
14. Për ofrimin e shërbimit me motopompë (largim të ujërave për shkak të reshjeve), subjekteve private, tarifa është 5,000 (pesë mijë) lekë për një orë.
15. Për trajnimin e personave, të subjekteve fizikë dhe juridikë për mbrojtjen nga zjarri nga strukturat e shërbimit të MZSH-së në Akademinë e Sigurisë (Qendra e Trajnimit Zjarrfikës), tarifa është 2,000 (dy mijë) lekë në ditë për person.
16. Për kryerjen e aktit të ekspertimit apo riekspertimit, nga strukturat e MZSH-së së bashkisë, në rastet e zjarreve të rëna në objekt, kur kërkohet nga subjekte fizikë e juridikë, tarifa është 20,000 (njëzetë mijë) lekë. Kjo tarifë nuk aplikohet kur akti i ekspertimit kërkohet nga Prokuroria.
17. Për të gjitha ndërhyrjet kur kërkohet nga subjekte fizikë e juridikë (zhbllokime dyersh, ashensorë, apo shërbime të tjera të ngjashme), që do të kryhen nga shërbimi zjarrfikës i bashkisë, tarifa është 2,000 (dy mijë) lekë.

TARIFA TË SHËRBIMIT ADMINISTRATIV TË BASHKISË DIBËR

2.12 TARIFA PËR SHËRBIMIN NË FUSHËN E TRANSPORTIT TË PASAGJERËVE DHE MALLRAVE, DHËNIEN E LEJEVE PËR USHTRIM AKTIVITETI.

TARIFA PËR TRANSPORTIN PUBLIK.

(për të tre grupet e njësive administrative)

Lekë/vit			
Nr.	Emërtimi	Njësia	Tarifa në lekë

I	<u>TRANSPORT UDHËTARËSH</u>		
	<u>Brenda vendit</u>		
1	Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Lekë/vit/linjë	10,000
		Lekë/5 vjet/linjë	40,000
2	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Lekë/mjet/vjet	2,000
		Lekë/mjet/5 vjet	10,000
3	Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	Lekë/vit/linjë	10,000
		Lekë/5 vjet/linjë	40,000
4	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	Lekë/mjet/vjet	2,000
		Lekë/mjet/5 vjet	10,000
5	Liçense për kryerjen e shërbimeve të rregullta të specializuara të transportit të udhëtarëve brenda vendit	Lekë/vit	10,000
		Lekë/5 vjet	40,000
6	Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve të rregullta të specializuara të transportit të udhëtarëve brenda vendit	Lekë/vit	2,000
		Lekë/5 vjet	10,000
7	Liçense për kryerjen e shërbimeve vajtje-ardhje (lavjerrës) të transportit të udhëtarëve brenda vendit	Lekë/vit/linjë	10,000
		Lekë/5 vjet/linjë	40,000
8	Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve vajtje-ardhje (lavjerrës) të transportit të udhëtarëve brenda vendit	Lekë/vit	2,000
		Lekë/5 vjet	10,000
9	Liçencë për transport udhëtarësh me	Lekë/vit/linjë	10,000

	taksi brenda vendit	Lekë/5 vjet/linjë	40,000	
II	<u>TRANSPORT MALLRASH</u> <u>Brenda vendit</u>		p/fizik	p/juridik
1	Licencë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit	Për licencë	3,000	8,000
		Lekë/5 vjet	40,000	
3	Çertifikatë për transport mallrash Brenda vendit për llogari të vet	Lekë/tonkapacitet Mbajtës	100	
		Lekë/kapacitet Mbajtës	100x5 vjet	
4	Çertifikatë për tërheqës	Lekë/tërheqës/vitet	2,000	
III	<u>SHËRBIME TRANSPORTI</u>			
1	Liçensë për agjenci transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit	Lekë/5 vjet	20,000	
2	Liçensë për agjenci ndërkombëtar udhëtarësh	Lekë/5 vjet	40,000	
3	Liçensë për kryerjen e shërbimeve të rregullta rrethqytetëse	Lekë/5 vjet	20,000	
4	Liçensë për kryerjen e shërbimeve të rregullta qytetëse	Lekë/5 vjet	20,000	

IV	<u>VEPRIMTARI TË TJERA</u>		
1	Autorizim i përkohshëm një mujor	Për autorizim	2,000

Për dublikatë me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmërie paguhet 15% e vlerës së plotë. Për rastet e ndryshimeve në licensë/certifikatë që kanë të bëjnë me elementet e përdoruesit të mjetit, fushës së operimit etj, paguhet 30% e vlefës së plotë.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së paisjes me licensë, certifikatë për transportin rrugor të automjeteve është Sektori i Licensimit pranë Bashkisë Dibër.

Për tarifën për licensë/certifikatë në fushën e transportit rrugor, detyrimi paguhet menjëherë me marrjen e licensës/certifikatës.

- Leje apo certifikatë vjetore (specifike përveç tarifës së regjistrimit për leje ushtrimi veprimtari ekonomike, bazuar në rregulloret përkatëse) për veprimtari servis të automjeteve, lavazheve, parkingut, pika tregtimi material ndërtimi (inerte, gëlqere etj, të ngjashme me to) është **5,000 lekë**.
- Licensë vjetore për lejimin e aktivitetit në përgatitjen e kursantëve për automjete (Autoshkolla) është **5,000 lekë**.

2.13. TARIFE PARKIMI TE AUTOMJETEVE

Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”i ndryshuar, Neni 35

TARIFË PARKIMI	Njësia Adm. Peshkopi	4 njësitë administrative	10 njësitë administrative
- autovetura taksi 4 + 1	8,000 lekë/vit/mjet	8,000 lekë/vit/mjet	8,000 lekë/vit/mjet
- autovetura taksi 8 + 1	8,000 lekë/vit/mjet	8,000 lekë/vit/mjet	8,000 lekë/vit/mjet
- autobusë	10,000 lekë/vit/mjet	10,000 lekë/vit/mjet	10,000 lekë/vit/mjet
- minibuza deri në 24 vende	4,000 lekë/vit/mjet	4,000 lekë/vit/mjet	4,000 lekë/vit/mjet
- automjet transport malli deri 3,5 ton	3,000 lekë/vit/mjet	3,000 lekë/vit/mjet	3,000 lekë/vit/mjet
- automjet transport malli deri 8 ton	4,000 lekë/vit/mjet	4 000 lekë/vit/mjet	4 000 lekë/vit/mjet
- automjet transport malli deri 14 ton	5,000 lekë/vit/mjet	5,000 lekë/vit/mjet	5,000 lekë/vit/mjet

- automjete transporti malli mbi 14 ton	6,000 lekë/vit/mjet	6,000 lekë/vit/mjet	6,000 lekë/vit/mjet
-mjetet e institucioneve, bankave	10,000 lekë/vit/mjet	10,000 lekë/vit/mjet	10,000 lekë/vit/mjet
-shoqëri e transportit të udhëtarëve mbi 8+1	10,000 lekë/vit/mjet	10,000 lekë/vit/mjet	10,000 lekë/vit/mjet
-shoqëri e transportit të udhëtarëve me taksi	10,000 lekë/vit/mjet	10,000 lekë/vit/mjet	10,000 lekë/vit/mjet

TARIFAT E AUTORIZIMEVE PER QARKULLIMIN NE QYTET kundër sinjalit Rrugor
Bashkia Dibër lëshon autorizime kundrejt tarifave si më poshtë vijon:

“Tarifa e autorizimit për qarkullim në qytet kundër sinjalit rrugor”

Nr.	Emërtimi	Njësia	Tarifa në lekë
1	Autorizim për lëvizje kundër sinjalit rrugor “Ndalim qarkullimi për kamione” me kapacitet maksimal (3,500-8,000) kg	Për mjet	10,000
2	Autorizim për lëvizje kundër sinjalit rrugor “Ndalim qarkullimi për kamione” me kapacitet maksimal (8,001-14,000) kg	Për mjet	10,000
3	Autorizim për lëvizje kundër sinjalit rrugor “Ndalim qarkullimi për kamione” me kapacitet maksimal mbi 14,000 kg	Për mjet	15,000

Dhënie autorizimi për lëvizje të automjeteve brenda unazës për periudha të përkohshme.

- * Automjete masa maksimale e autorizuar mbi 3.5 T –7.5 T 3,000 lekë/muaj/mjet
- * Automjete masa maksimale e autorizuar mbi 7.5 T –12 T 5,000 lekë/muaj/mjet
- * Automjete masa maksimale e autorizuar mbi 12 T – 18 T 7,000 lekë/muaj/mjet
- * Automjete masa maksimale e autorizuar mbi 18 T - 10,000 lekë/muaj/mjet

Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr.09 datë 31/01/2024 “Për miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit të destinuara për parkim në qytetin e Peshkopisë si dhe tarifave të shërbimit të arkëtimit të administruara nga Bashkia Dibër”.

SHTOJCA NR.1

Kriteret për përcaktimin e Zonave të Administrimit të Parkimit dhe nënzonat e tyre.

1. Zona e administrimit në territorin e Bashkisë Dibër janë zona që përfshihen në sistemin e kontrolluar të administrimit të parkimit nga Bashkia Dibër.

2. Zona të administrimit të parkimit konsiderohen zonat që plotësojnë kriteret sipas:

a) Përcaktimeve të Kodit Rrugor dhe akteve nënligjore në zbatim të tij ku përfshihen të gjitha karakteristikat /normat teknike dhe funksionale që lidhen me përcaktimin e parkimit dhe ndërlidhjen me elementet e rrugës ose jo.

b) Planit të Transportit ku përfshihen të gjitha elementet e planifikimit të transportit që krijojnë/mundësojnë realizimin e zonave/nënzonave të shërbimit të parkimit.

c) Planit të qarkullimit të mjeteve ku përfshihen të gjitha mundësitë që ofron plani i lëvizjes në raport me karakteristikat/normat teknike të përcaktimit të vendeve të parkimit.

d) Kushteve të infrastrukturës rrugore ku përfshihen e kushtet fizike të infrastrukturës rrugore, e rikonstruktuar ose e parikonstruktuar dhe lidhja e saj me karakteristikat/normat/teknike të përcaktimit të vendeve të parkimit.

e) Kategorizimeve të rrjetit rrugor dhe zonave jashtë rruge sipas shkallës së intensitetit të aktivitetit social ekonomik:

I. Kategoria I - Rrugë dhe zona jashtë rruge që vlerësohen me aktivitet të dendur/ intensitet social ekonomik sidomos në rrugët me aktivitet tregtare sipas të dhënave të grumbulluara.

II. Kategoria II - Rruge dhe zonat jashtë rruge që vlerësohen jo me aktivitet të dendur social dhe ekonomik dhe jo me aktivitet të dendur tregtar, por që kanë intensitet mesatar të fushave të mesiperme sipas të dhënave të grumbulluara.

III. Kategoria III - Rrugë dhe zonat jashtë rruge që vlerësohen ose jo me aktivitet të dendur social dhe ekonomik dhe me aktivitet të vogël/ ose fare tregtare sipas të dhënave të grumbulluara.

f) Kriteri i kërkesë/ofertës: Disponibilitetin e hapsirave rrugore dhe zonave jashtë rruge për vendparkime të ofertës dhe kërkesës për parkim sipas shkallës së zonës ku ndodhet:

i) Kategoria I

a. Shkalla e zënies > 110% në momentet e jopikut

ii) Kategoria II

a. Shkalla e zënies deri në 80% në momentin e pikut

b. Shkalla e zënies deri në 60% në momentet e pikut

iii) Kategoria III

- a. Shkalla e zënies deri në 60% në momentin e pikut
 - b. Shkalla e zënies 40% në momentin e jopikut.
1. Zonat e administrimit të Parkimit (ZAP) detajohen në nënzona. Detajimi identifikohen zonat e destinuara për parkim-në rrugë dhe/ose jashtë rruge në zonat (NDP) Nënzonat e Dedikuara në Parkim.
 2. NDP - të pa pagesë në rrugë dhe/ose jashtë rruge Brenda ZAP-ve përfshijnë:
 - a. Parkim në lagje.
 - b. Parkim i lirë ose pa sistem kontrolli të kohëzgjatjes së qëndrimit pranë stadiumit të Peshkopisë (pa pagesë).
 - c. Parkimi i rezervuar për automjetet e personave me aftësi të kufizuara pa pagesë.
 3. Kriteret për përcaktimin e NDP pa pagesë në rrugë dhe zonat jashtë rruge brenda ZAP-ve.
 - a. Rezervimi i një numri të caktuar vendesh parkimi për automjetet e personave me aftësi të kufizuar (PAK) dhe parkim të lirë pa roja ose pa sistem (PL) në masën jo më e vogël se 2% NDP.
 - b. Rezervimi i një numri të caktuar vendesh parkimi për automjetet e banorëve (A) ka si kriter vlerësimi kriteret që lidhen me kategorizimin e rrjetit rrugor dhe kërkesës/ofertës ku ndërthurja e kategorisë 3 të rrjetit rrugor dhe kategorisë 1.3 të kërkesës/ofertës mundëson një rezervim:
 - i) Deri 70% të NDP në favor të (A)
 - ii) Deri në 30% të NDP në favor të (PL) dhe (PAK).
 4. Vlerësimi i NDP pa pagesë në raport % (përqindje) me NDP e parkimit me pagesë varion/kryhet rast pas rasti sipas ndërthurjes së treguesve të kategorizimit të rrjetit rrugor dhe kërkesës/ofertës për cdo ZAP.
 5. NDP me pagesë në rrugë dhe/ose në zonat jashtë rruge Brenda ZAP-ve janë:
 - a. Vendparkim me pagesë.
 - b. Vendparkim i rezervuar.
 6. Kriteret për përcaktimin e NDP me pagesë në rrugë dhe/ ose jashtë rruge Brenda ZAP-ve.
 - a. Rezervimi i një numri të caktuar vendesh parkimi me pagesë kur vlerësimi sipas kriterëve NDP-së që lidhen me kategorizimet e rrjetit rrugor dhe kategorizimet e kërkesës/ofertës krijon

ndërthurje të kategorisë 1.1 të Rrjetit Rrugor dhe Kategorisë 1.1 të kërkesës/ofertës mundëson një rezervim nga 50% deri në 100% të NDP-së në favor të parkimit me pagesë.

b. Rezervimi i një numri të caktuar vendesh parkimi të rezervuar me pagesë dhe/ ose taksi bëhet në një masë jo më të madhe se 20% - 30% e NDP-së.

c. Vlerësimi i NDP-ve me pagesë në raport % (përqindje) me NDP-të e parkimit pa pagesë varion rast pas rasti sipas ndërthurjes së treguesve të kategorizimit të rrjetit rrugor dhe kërkesës/ofertës për cdo NDP.

d. Ditët e shërbimit të parkimit me pagesë dhe rrugë dhe zonat jashtë rruge janë nga e hëna në të shtunën.

e. Për rrugët ose/dhe zonat jashtë rruge që vlerësohen nga drejtoria përkatëse se gjatë fundjavave kanë aktivitet intensiv social dhe ekonomik sistemi i kontrollit do të operojë nga e hëna në të shtunën (sidomos në rrugët me aktivitet tregtar, të njohura si rrugët/ zona tregtare).

f. Parkimi me pagesë në zonat e miratuara si të tilla do të shtrijnë kohëzgjatjen prej orës 8:00 deri në orën 20:00, zona e parkimit në shesh do të alternohet sipas vendimit të këshillit bashkiak për qarkullimin e mjeteve në këtë zonë.

g. Në të gjitha zonat cdo kategori parkimi në rrugë pas orës 20:00 deri në orën 08:00 është parkim i lirë i pa rezervuar, pa pagesë.

h. Në zona të caktuara të shërbimit të parkimit pa pagesë, vendoset kufizimi i kohëzgjatjes së qëndrimit me pagesë 1 orë deri në jo me shumë se 4 orë në të njëjtin vend me pagesë. Vendimi përkatës merret nga Kryetari i Bashkisë nëse një rrugë ka kërkesë të lartë për parkim, për shkak të vendodhjes afër:

a. Zonave tregtare/ tregjeve,

b. Zonave ku ofrohen shërbime të ndryshme publike dhe private.

SHTOJCA 2

Zona e Administrimit të Parkimit (ZAP) në qytetin e Dibrës

Zona A:

Ku do të përfshihen sheshet si dhe të gjithë segmentet rrugore ku intensiteti i aktiviteteve tregtare ku kërkesa për parkim është më e lartë:

Zona A:

Pasqyra e ZAP Zona A

EMRI RRUGES/SHESHIT	PARKIM PUBLIK DHE REZERVUAR ME PAGESE	PARKIM PA PAGESE (individuale)
---------------------	--	-----------------------------------

Rruga Nazmi Rushiti	50 vende	2 vende
Rruga Abdyl Frasheri	50 vende	2 vende
Rruga Tercilio Kardinali	26 vende	2 vende
Rruga Tercilio Kardinali2	22 vende	3 vende
Rruga Gjergj Kastriot Skenderbeu	5 vende	0
Rruga Faik Shehu	72 vende	3 vende
Sheshi Edip Tershana	84 vende	2 vende
Gjithsej	209 vende	14 vende

Sheshi Edip Tërshana do të lejohen të parkohen automjetet 4 +1.

7. Drejtoria respektive në bashki kur vlerëson së janë plotësuar kushtet për shtrirjen e sistemit të parkimit, propozon për miratimin pranë kryetarit plotësimin, përmirësimin ose shtimin e NDP me nënzonat respektive në mbështetje të kriterëve të percaktuara në kapitujt përkatës. Gjithashtu e njëjta procedurë ndiqet në rastin kur NDP me nënzonat respektive bie ndesh me projektet për zbatim të korsive të dedikuara transportit publik, duke bërë rishikimin e NDP ose nënzonave sipas rastit.

8. Bashkia e Dibrës të marrë masa për paisjen e rezidentëve me autorizimet perkatese për evidentimin e tyre në zonat e administrimit të parkimit (ZAP) ku banojnë me lagje.

SHTOJCA 3

Zona Tarifore dhe Tarifat e Shërbimit të Parkimit të Administruara nga Bashkia e Dibrës.

1. Ndarja në Zona Tarifore sipas topologjive.

Zona tarifore - me qëllim vendosjen dhe marrjen e tarifës së shërbimit të parkimit publik me pagesë mbështetur në karakteristikat funksionale të tyre ndahen si më poshtë:

Zona A: Përfshin zonat më të nxehta ku mbizotërojnë shkëmbimet tregtare, financiare institucionale apo sociale me intensitet të lartë. Një pjesë e rrjetit rrugor të kësaj zone mban/përcjell aktivitetin e qendrave të biznesit, bankat, institucionet kulturore dhe artistike, lokalet dhe njësitë e shërbimit etj.

Për këtë arsye niveli i nevojave për vendparkim është krahasimisht më i vogël.

2. Tarifat e shërbimit të parkimit

2.1 Tarifa bazë e shërbimit të parkimit të administruar nga Bashkia e Dibrës përcaktohet si më poshtë vijon:

Zona A

a. Tarifa për vendparkim në rrugë

50 lek/ora 0–1 orë

Autovetura sipas intervalit të qëndrimit	Tarifa/Lekë
0–5 minuta	0 lekë
0–1 orë	50 lekë
24 orë	500 lekë

Mungesa e biletës sanksionohet me 1,500 lekë gjobë.

2.2 Në varësi të zhvillimit social ekonomik të njësive administrative të Bashkisë Dibër, Kryetari i Bashkisë Dibër nëpërmjet një urdhëruese mund të caktojë nivele të ndryshme të tarifave të shërbimit të parkimit në kufijtë minus 30% plus 30% të tarifës bazë.

2.3 Në varësi të ndryshme të kërkesës dhe ofertës në treg Kryetari i Bashkisë Dibër i propozon Këshillit Bashkiak nëpërmjet një urdhëruese mund të përcaktojë nivele të ndryshme të tarifave të shërbimeve të parkimit në kufijtë minus 30% plus 30% të tarifës bazë.

2.4 Nga 0–5 min parkimi do të jetë falas për të gjithë. A nga 0–1 orë parkimi do të jetë 50 lekë me të drejtë rinovimi dhe njëhere tjetër.

2.5 Të ngarkojë Drejtorinë e Shërbimeve Bashkiake dhe Drejtorinë e Mbrojtjes Civile dhe Pronave dhe Drejtorinë Ekonomike.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së parkimit është Sektori i Liçensimit pranë Bashkisë Dibër.

— PARKINGJET E REZERVUARA —

Vendimi I Këshillit Bashkiak nr.42 datë 18/07/2024 “Për një shtesë në vendimin Nr .09 datë 31/01/2024” Për miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit të destinuara për parkingjet e rezervuara në qytetin e Peshkopisë si dhe tarifave të shërbimit të arkëtimit të administruara nga Bashkia Dibër”

ZONA A

Autovetura sipas intervalit te qendrimit	Tarifa/Leke/ne vit /365 dite
VENDPARKINGU I PARE	40 000
VENDPARKINGU I DYTE	60 000

- Për 1 vendparkim të rezervuar për një periudhë 1 vjecare pagesa do të jetë 40 000 lekë.
- Për vendparkimin e dytë pagesa do të jetë 60 000 lekë.

Tarifa e parkimit të rezervuar

Leja e vendparkimit të rezervuar do te jepet sipas kërkesës së subjektit,por në asnjë rast s' do të jetë më pak se 8 orë në ditë dhe jo më pak se 5 ditë në javë. Në këtë rast:

a) Përgatitja e sinjalistikës vertikale (tabelave) kryhet prej vetë subjektit të interesuar bazuar në sinjalistikën standarte të miratuar.

b) Vendosja e sinjalistikës vertikale dhe asaj horizontale do të kryhet nga ana e Bashkisë Dibër. Struktura e ngarkuar për miratimin e lejes për vendparkim të rezervuar, përlllogaritjen e tarifës së parkimit është Drejtoria e Kontrollit të Territorit.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së parkimit është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Dibër.

Struktura e ngarkuar për penalitetet për mospajisje me leje për vendparkim të rezervuar, mos respektim të kushteve të lejes është Drejtoria e Kontrollit të Territorit dhe Policia Bashkiake.

Përsa i përket mbajtësve të kartës së rezidentit në zonat e parkimit të miratuara për rezidentët.

Struktura e ngarkuar për pajisje, përlllogaritjen dhe vjeljen e tarifës së kartës së rezidentit është Drejtoria e Kontrollit të Territorit në Bashkinë Dibër.

Struktura e ngarkuar për penalitetet për mospajisje me kartë rezidenti dhe mos respektim të kushteve apo sinjalistikës të vendosur në këto zona është Policia Bashkiake.

TARIFA E SHËRBIMIT VETERINAR

II	TARIFË PËR KONTROLL DHE THERJEN E BAGËTIVE	Njësia Peshkopi	4 njësitë administrative	10 njësitë administrative
	-Të imëta	200 lekë/kokë	200 lekë/kokë	200 lekë/kokë
	-Të trasha	400 lekë/kokë	400 lekë/kokë	400 lekë/kokë

2.14 TARIFË VETERINARIE

Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”i ndryshuar, Neni 35

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës për therrjen e bagëtive është Drejtoria e Shëndetësisë, Veterinarisë Higjienës Prodhimit Bujqësor dhe Ushqimit në Bashkinë Dibër.

3. TË ARDHURA JO TATIMORE

Baza ligjore për të ardhurat nga privatizimi VKM nr.97 datë 3.2.2008 “Për procedurat e privatizimit të banesave” objekt i ligjit 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe ligjit 9321 datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa me fonde të shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore” dhe VKB nr.153 dt.11.12.2012 “Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave”. Të ardhurat nga privatizimi paguhen nga përfituesi i pronës. Drejtoria Juridike ose komisioni përgjegjës përcjell dokumentacionin e përpunuar për lëshimin e faturës tek Drejtoria e të Ardhurave që lëshon faturën për arkëtim.

3.1. TARIFA PËR PRIVATIZIM, DHËNIE ME QERA

VKM Nr.54 datë 05.02.2014 VKM Nr.1533 datë 19.11.2008	QYTETI PESHKOPI	JASHI E QYTETIT PESHKOPI
Qera për ndërtesë	75 lekë/m ² muaj muaj	50 lekë/m ²
Qera trualli	100 lekë/m ² muaj	
Qera trualli funksional	20% e Qerasë Nd lekë/m ² /muaj	

4. KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE (GJOBAT)

1. Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregtar pa licensë, autorizim apo leje përkatëse të jetë si më poshtë:	
a. Mospajisja me licensë, autorizim apo certifikatë përkatëse transporti :	
transport udhëtarësh taksi (1+4)	5,000 lekë
transport udhëtarësh taksi (1+8)	5,000 lekë
mjete të tonazhit të lartë	10,000 lekë
hyrja pa autorizim në rrugët kryesore të qytetit për mjetet e tonazhit të lartë	10,000 lekë

b. Mospajisje me leje për tregtimin me pakicë të karburanteve dhe njësive të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombulave të gazit	10,000 deri 20,000 lekë
c. Mospajisje me leje për tregti ambulante, kantine	1,000 deri 5,000 lekë
d. Mos pajisje me leje për shërbim me tavolina jashtë lokalit	1,000 lekë
e. Mospajisje me leje për ushtrim aktiviteti "24 orësh"	1,000 lekë
f. Mospajisje me leje për zenie të hapësirës publike	
eksponim malli	5,000 lekë
veprimtarive të cilat do të zhvillohen në hapësirat publike	5,000 lekë
g. Mospajisje me leje për vendosje reklame:	
• e thjeshtë	5,000 lekë
• elektronike	10,000 lekë
h. Mosmarrja e masave për izolimin e ambjentit për daljen zhurmave nga ambientet e lokaleve	10,000 lekë

5. Mos respektim i rregullave të qarkullimit të jetë si më poshtë:

a. Parkim të gabuar të mjetit	1,000 lekë
b. Qarkullim i mjetit duke shkelur rregullat e qarkullimit (sinjalistikës)	500 – 2,000 lekë

6. Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore të jetë si më poshtë :

a. Dëmtim rruge	10,000 lekë
b. Çarje rruge	10,000 lekë
c. Bllokim rruge	10,000 lekë
d. Dëmtim bordure	5,000 lekë
e. Dëmtim trotuari	10,000 lekë
f. Çarje trotuari	10,000 lekë
g. Bllokim trotuari	5,000 lekë
h. Dëmtim, bllokim, vjedhje pusete	10,000 lekë
i. Ndotje të rrugëve nga mjetet e transportit për punime në qytet :	
- persona juridikë	20,000 lekë
- persona fizikë	10,000 lekë
- qytetarë	5,000 lekë

7. Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin e ndriçimit rrugor të jetë si më poshtë :

a. Lidhje e pamiraturar në rrjetin ajror	20,000 lekë
b. Dëmtim të shtyllave të ndriçimit	10,000 lekë
c. Dëmtim i ndriçuesve	10,000 lekë
d. Përdorimi i shtyllave të ndriçimit si suport për montimin e reklamave, kapjen e kablllove etj,	10,000 lekë
e. Dëmtim i traseve, kablllove dhe linjave ajrore nga punimet që kryhen pranë tyre me leje dhe pa leje si dhe shkulja e shtyllave	20,000 lekë
f. Ndërhyrje në kuadrot elektrik publik	10,000 lekë

8. Niveli i gjobave për dëmtime dhe ndërhyrje në rrjetin e ujësjellësit:

a. Lidhje e pa miraturar në tubacion	10,000 lekë
b. Dëmtim i pushtave	10,000 lekë
c. Dëmtimi i tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre me leje ose pa leje	10,000 lekë

9. Niveli i gjobave për ndërhyrje dhe dëmtime në hapësirat e gjelbëra dhe publike të jetë si më poshtë:

a. Dëmtim i hapësirave publike të gjelbërta	10,000 lekë
b. Dëmtim, prerje e pemëve	10,000 lekë
c. Zënie e hapësirës të gjelbër pa leje	10,000 lekë
d. Vendosje tabelash, pankartash, banderolash pa leje	5,000 lekë
e. Vendosje posterash pa leje	100 lekë/copë
f. Mos hedhje mbeturinash në vendin e caktuar	1,000 – 5,000 lekë
Për banorët	
Për bizneset e vogla	5,000 – 10,000 lekë
Për bizneset e mëdha	10,000 -- 50,000 lekë

10. Niveli i gjobave në Zyrën e Taksave dhe Tarifave Vendore

Niveli i gjobave për mos-shlyerjen e Taksave dhe Tarifave Vendore	Sanksionet
a. Mos pagim i taksave vendore në afatin e	5,000 --- 30,000 lekë

duhur	
b. Fshehje e detyrimit fiskal	10,000 --- 50,000 lekë
c.Falsifikimi i detyrimit fiskal	10,000 --- 50,000 lekë
d.Mos dhënia e informacionit	5,000 --- 20,000 lekë
e.Mos njoftimi për ndryshime në të dhënat e taskapaguesve	10,000 --- 30,000 lekë

11.Niveli i gjobave për shkeljet e kryera nga shoqëritë e ndërtimit

Niveli i gjobave për shkeljet e kryera nga shoqëritë e ndërtimit	Sanksionet
a.Ndotje të hapësirave publike jashtë rrethimit të kantierit të ndërtimit nga inerte apo materiale të tjera ndërtimore.	8,000 m ² 5,000 m ² në rastet e përsëritura
b. Për rastet kur kamionet,që transportojnë materiale ndërtimore nuk janë të mbuluar dhe krijojnë ndotjen e hapësirave pulike gjatë transportit.	20,000 lekë
c.Mos respektimi i kushteve brenda kantierit të ndërtimit për zbritjen e mbeturinave ndërtimore nëpërmjet vendosjes së tubave të posacme nga katet e mësipërme duke u hedhur më pas në kantierin e grumbullimit të mbeturina ndërtimore.	50,000 lekë 100,000 lekë për rastet e përsëritura
d. Për mungesën e rrjetave mbrojtëse në objekte të cilat shërbejnë për evitimin e ndotjes së ambjentit,nga pluhurat si dhe respektimin e sigurisë teknike në ambient.	50,000 lekë 100,000 lekë për rastet e përsëritura

12. Niveli i gjobave në Sektorin e INUV

Kundravajtjet Administrative	Sanksionet
Ligji nr 107/2014 “Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” Në kuptim të këtij ligji,shkeljet e mëposhtme pavarësisht nëse përbëjnë vepër penale,përbëjnë kundravajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:	8,000 m ² 5,000 m ² në rastet e përsëritura
dh. Shkelje të afatit të fillimit apo përfundimit të punimeve,sipas nenit 40 të këtij ligji.	1,000,000 – 5,000,000 lekë
e. Kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje,por në cdo rast jo mëe pak 500,000 dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve te kryera.	500,000 lekë Konfiskim te punimeve të kryera.

Mbledhja e gjobave nga kundravajtjet administrative do të bëhet nga Sektori i Policisë Bashkiake.

Të ardhurat e realizuara nga mbledhja e gjobave do të ndahen sipas përcaktimit që bën Ligji Nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjen administrative”.

Përfshihen nga pagesa të gjitha rastet e parashikuara me Ligj: ligji nr. 7874, datë 17.11.1994 “për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashiste të popullit shqiptar”, i ndryshuar, ligji Nr.7889, datë 14.12.1994 “për statusin e invalidit”, Nr.8098, datë 28.3.1996 “për statusin e të verbërit”, i ndryshuar përfshihen nga çdo lloj takse dhe tatimit të drejtpërdrejtë si:

- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Tarifa e pastrimit dhe Shërbimeve komunitare

Personat:

- a. Invalidët dhe veteranët e luftës
- b. Invalidët e punës
- c. Të verbërit
- d. Invalidët paraplegjik dhe tetraplegjik që e fitojnë këtë status
- e. Emigrantet pa shtëpi banimi në Bashkinë e Dibrës

Për pikat **a, b, c, d, e**, me kushtin që të jenë kryefamiljarë dhe pa persona të tjerë madhorë, përveç bashkëshortit ose bashkëshortes në certifikatën familjare.

Librezën e veteranit ose invalidit të luftës, statusin e invalidit të punës, statusin e të verbërit, të sëmurëve paraplegjikë e tetraplegjikë, vertetimin e të perndjekurit politik dhe vërtetimin nga Njësia Administrative për përfituesit e ndihmës ekonomike.

Mbledhja e tyre do të bëhet nga vetë strukturat e Bashkisë dhe agjentët tatimorë të përcaktuar sipas ligjit “Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Dibrë dhe penalitetet për kundravajtjet administrative për vitin 2026”.

PËRCAKTIME

Në rastet e bizneseve që kanë adresë sekondare të regjistruara të automjeteve, mjete transporti, tarifave vendore gjelbërim, pastrim dhe ndriçim, llogariten e paguhen vetëm për selinë e regjistruar të biznesit, adresat sekondare nuk tarifohen. Për të gjitha subjektet që çregjistrohen ose të pezulluar brenda datës 30 qershor ngarkesa nuk do të jetë vjetore por përpjestimisht nga data 01 Janar e vitit fiskal deri në datën e kryerjes së aplikimit për çregjistrim në QKB, me përjashtim të rasteve kur konstatohet ndryshe nga Sektori i Kontrollit pranë ZTTV. Për çdo subjekt që hapet rishtas/riaktivizohet gjatë vitit fiskal, ngarkesa fiskale do të jetë përpjestimore duke nisur nga data e regjistrimit deri në fund të vitit fiskal.

Çdo taksapagues ka të drejtë të ankohet me shkrim për shumën dhe mënyrën se si janë vlerësuar detyrimet e tij, të kërkojë rimbursime si dhe të apeloje kunder çdo veprimi ose mosveprimi nga strukturat përkatëse në Bashkinë Dibër.

ANKIMI

Ankimi paraqitet me shkrim pranë Kryetarit të Bashkisë brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për aktin administrativ dhe përmban:

- a) emrin, adresën dhe NIPT-in e apeluesit
- b) vitin tatimor, me të cilin lidhet apelimi
- c) natyrën dhe shumën e tatimit ose gjobës që është subjekt apelimi
- d) baza ku mbështetet apelimi.

Subjekti duhet të përmbushë kërkesat e ligjit për parapagimin e detyrimeve përpara depozitimit të ankimit administrative.

Procedurat e apelimit dhe procedurat e shqyrtimit të apelimit tatimor, bazohen në përcaktimet e bëra në ligjin "Për Procedurat Tatimore" dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë në zbatim të tij. Kryetari i Bashkisë shqyrton ankimin dhe merr vendim brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit. Kundër vendimit të Kryetarit të Bashkisë, subjekti ka të drejtë të ankohet në Gjykatë brenda 30 ditëve nga çasti i marrjes në dijeni për vendimin e mësipërm.

Baza Ligjore

Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, përbën ligjin bazë për reformat e decentralizimit të pushtetit vendor dhe përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të krijimit të taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe ligjin nr.9975 datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, në të ardhurat vendore përfshihen kryesisht:

- Tatimi i thjeshtuar mbi BV;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja;
- Taksa mbi pasurine e paluajteshme;
- Taksa për transferimin e pasurisë së patundshme;
- Taksa për automjetet/mjetet e përdorura;
- Taksa e tabelës/reklamat;
- Taksa e fjetjes në hotel
- Taksa mbi renten minerare;
- Taksa të përkohshme;

- Tarifa për shërbime;

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur jepet legjislacioni fiskal vendor, i cili është konsultuar për të hartuar këtë paketë fiskale.

Ligje:

Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar me Ligjin nr.9745 datë 28.05.07; ndryshuar me Ligjin nr.9764, datë 09.07.2007; ndryshuar me Ligjin nr.9931, datë 09.06.2008; ndryshuar me Ligjin nr.10 073, datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10117 dt. 23.4.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10146 dt.28.9.2009; ndryshuar me Ligjin Nr. 10354 , datë 18.11.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10457, datë 21.07.2011; ndryshuar me Ligjin nr.106/2013, datë 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin nr.181/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr.85/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, dt. 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr.142/2015, datë 17.12.2015.

Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore".

Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, ndryshuar me Ligjin nr.9483 datë 16.2.2006, i ndryshuar me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006; ndryshuar me Ligjin nr.9716 datë 16.04.2007; ndryshuar me Ligjin Nr. 9735 datë 17.05.2007; ndryshuar me ligj nr.9766 datë 09.07.2007; ndryshuar me Ligjin nr.9804 datë 13.09.2007; ndryshuar me Ligjin nr.9844 datë 17.12.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9943, datë 26.6.2008; ndryshuar me Ligjin nr.10072, datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin nr.10228, datë 4.2.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010; ndryshuar me Ligjin nr.10364, datë 16.12.2010; ndryshuar me Ligjin Nr. 20/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me Ligjin nr.71/2012, datë 28.6.2012; ndryshuar me Ligjin Nr. 122/2012, datë 20.12.2012; ndryshuar me Ligjin Nr. 107/2013, date 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin nr.124/2013, datë 25.4.2013; ndryshuar me Ligjin Nr. 177/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin Nr. 32/2014, datë 3.4.2014; ndryshuar me Ligjin Nr. 42/2014, datë 24.4.2014; ndryshuar me Ligjin Nr. 83/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 156/2014, dt. 27.11.2014;

Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", I ndryshuar;

Ligji nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën eShqipërisë" i ndryshuar";

Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë";

Ligji nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar me Ligjin Nr.10 065, date 29.1.2009, ndryshuar me Ligjin Nr. 10 131 dt. 11.5.2009, ndryshuar me Ligjin nr. 10145, datë 28.9.2009, ndryshuar me Ligjin nr.10280, dt.20.5.2010, ndryshuar me Ligjin Nr. 10458, datë 21.7.2011. ndryshuar me Ligjin Nr. 83/2012, datë 13.9.2012. Ndryshuar me Ligjin Nr. 120/2013, datë 18.04.2013.ndryshuar me Ligjin Nr. 178/2013, datë 28.12.2013. Ndryshuar me Ligjin Nr. 86/2014, datë 17.07.2014, ndryshuar me Ligjin Nr. 157/2014, datë 27.11.2014;

Ligji nr. 93/2015 "Për turizmin";

Ligji Nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar;
 Ligji Nr 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
 Ligji Nr.10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”;
 Ligji Nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar;
 Ligji. Nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”;
 Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullësor”, i ndryshuar;
 Ligji Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”;
 Ligji Nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar me Ligjin Nr.9561, datë 12.6.2006 dhe Ligjin Nr.9797, datë 23.7.2007;
 Ligji Nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;
 Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar;
 Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”;
 Ligj nr.106/2017 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar;

Vendime dhe udhëzime:

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.132,date 07.03.2018 “Per Metodologjine per percaktimin e vleres se taksueshme te pasurise te paluajtshme”.

Vendim i Keshillit te Ministrave Nr.319,date 31.05.2018 “Per Miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve”.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 505, datë 1.8.2007 “Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit”;

Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 783, datë 10.11.2011, ”Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore”;

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.7, datë 4.01.2012, "Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare", i ndryshuar.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 970, dt 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” ;

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 396, datë 21.6.2006 “Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore”;

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. nr. 391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”;

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 632 datë 11.06.2009 “Për tarifatat në sektorin e Kullotave”;

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. nr.1064 datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”;

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”;

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 992, datë 9.12.2015 “Për disa ndryshime në vendimin nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar;

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.469, datë 3.6.2015, "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”;

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 285, date 27.6.2002 “Për tarifat e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj”;

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.1108, date 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe Administrimit të ujërave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”;

Vendim nr.607, datë 29.7.2020 për tarifat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit.

Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.1, datë 12.1.2007 “Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”;

Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.32, datë 31.12.2013, "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", i ndryshuar.

Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.26, datë 4.09.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar.

Udhëzim i Përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë) Nr. 655/1, date 06.02.2007 “Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Procedurale dhe të Raportimit të Sistemit të taksës Vendore”; Udhëzim i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 6756, date 3.9.2015 “Për zbatimin e vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar; Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011, "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar; Udhëzuesi i Ministrit për Çeshtjet Vendore nr 541/1, date 31.12.2015 “Udhëzues për zbatimin e VKM nr.1108 datë.30.12.2015 "Për transferimin nga MBZHRAU tek bashkitë, të infrastructures së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme”;

PËR ZBATIMIN E KËTIJ VENDIMI NGARKOHEN TË GJITHE DREJTORITË E BASHKISË DIBËR SI DHE INSTITUCIONET NË VARËSI TË SAJ.

PËR BASHKINË DIBËR

PËRGJEGJËS I TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

BUJAR MANJA

DREJTORI TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

FITIM RASKA

DREJTORIA JURIDIKE

ISMET SARAÇI

KRYETARI I BASHKISË

